

# Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 19

## Përfitimet e punonjësve

### Objektivi

---

Objektivi i këtij Standardi është të përshkruajë trajtimin kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për përfitimet e punonjësve. Standardi i kërkon një njësi ekonomike të njohë:

- (a) një pasiv kur një punonjës ka kryer shërbim në këmbim të përfitimeve të punonjësit që janë të pagueshme në të ardhmen; dhe
- (b) një shpenzim kur njësi ekonomike e konsumon përfitimën ekonomik që lind nga shërbimi i kryer nga një punonjës në këmbim të përfitimeve të punonjësit.

### Objekti

---

- 1 **Ky Standard zbatohet nga një punëdhënës për kontabilizimin e të gjitha përfitimeve të punonjësve, me përjashtim të atyre për të cilat zbatohet SNRF 2 *Pagesa e bazuar në aksione*.**
- 2 Ky Standard nuk trajton raportimin që bëjnë skemat e përfitimeve të punonjësve (shih SNK 26 *Kontabiliteti dhe raportimi nga skemat e përfitimeve të pensioneve*).
- 3 Përfitimet e punonjësve për të cilat zbatohet ky Standard përfshijnë ato përfitime që ofrohen:
  - (a) në kuadër të skemave formale ose akt-marrëveshjeve të tjera formale midis një njësi ekonomike dhe punonjësve, grupeve të punonjësve ose përfaqësuesve të tyre;
  - (b) në kuadër të kërkesave ligjore, ose të akt-marrëveshjeve të sektorëve të ekonomisë, sipas të cilave u kërkohet njësi ekonomike të japin kontribut në skemat kombëtare, shtetërore, sektoriale ose skemave të tjera me disa punëdhënës; ose
  - (c) në bazë të praktikave joformale të cilat krijojnë një detyrim konstruktiv. Praktikave joformale sjellin një detyrim konstruktiv atëherë kur njësi ekonomike nuk ka alternativë tjetër realiste përveç se t'i paguajë përfitimet e punonjësve. Shembull i një detyrimi konstruktiv është kur një ndryshim i praktikave joformale të njësisë ekonomike do të shkaktonte një dëm të papranueshëm ndaj marrëdhënieve të saj me punonjësit.
- 4 Përfitimet e punonjësve përfshijnë:
  - (a) përfitime të punonjësve afatshkurtra, siç janë pagat, pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, leja vjetore e paguar dhe raporti mjekësor i paguar, pjesëmarrja në fitime dhe shpërblimet (nëse janë të pagueshme brenda 12 muajve pas fundit të periudhës) dhe përfitime jo monetare (siç janë kujdesi shëndetësor, strehimi, autoveturat dhe mallrat ose shërbimet pa pagesë ose të subvencionuara) për punonjësit aktualë;
  - (b) përfitime pas përfundimit të marrëdhënieve të punës, siç janë pensionet, përfitime të tjera pleqërie, sigurimi i jetës pas përfundimit të marrëdhënieve të punës dhe kujdesi shëndetësor pas përfundimit të marrëdhënieve të punës;
  - (c) përfitime të tjera tjera afatgjata, përfshirë lejet për shërbimin afatgjatë ose lejet për shërbimin në ditët e pushimit javor, të përvjetorëve ose përfitime të tjera për shërbim afatgjatë, përfitime për paaftësi në punë afatgjatë dhe, nëse janë të pagueshme 12 muaj apo më shumë pas fundit të periudhës, pjesëmarrja në fitime, shpërblimet dhe kompensimet e shtyra; dhe
  - (d) përfitime nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës.

Ngaqë secila kategori e identifikuar në pikat (a)-(d) më lart ka karakteristika të ndryshme, ky Standard vendos kërkesa të veçanta për secilën kategori.
- 5 Përfitimet e punonjësve përfshijnë përfitimet që u jepen punonjësve ose personave në varësi të tyre dhe mund të shlyhen përmes pagesave (ose dhënies së mallrave ose shërbimeve) që u bëhen ose drejtpërdrejt punonjësve, bashkëshortëve, fëmijëve apo personave të tjerë në ngarkim të tyre, ose palëve të tjera, siç janë shoqëritë e sigurimeve.

- 6 Një punonjës mund t'i ofrojë shërbim një njësie ekonomike me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, në mënyrë të përhershme, në mënyrë të rastësishme ose në mënyrë të përkohshme. Për qëllimet e këtij Standardi, punonjësit përfshijnë edhe drejtorët dhe punonjësit e tjerë drejtues.

## Përkufizime

---

- 7 Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore që përdoren në këtë standard:

*Përfitimet e punonjësve* janë të gjitha format e shumave që jep një njësi ekonomike në këmbim të shërbimit të kryer nga punonjësit.

*Përfitimet e punonjësve afatshkurtra* janë përfitimet e punonjësve (përfashtuar përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës) të cilat maturohen tërësisht brenda 12 muajsh pas mbylljes së periudhës në të cilën i realizojnë punonjësit shërbimet e lidhura me to.

*Përfitimet e pas-punësimit* janë përfitimet e punonjësve (përfashtuar përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës) të cilat janë të pagueshme pas përfundimit të marrëdhënieve të punës.

*Skemat e përfitimeve të pas-punësimit* janë marrëveshje formale ose joformale në kuadër të të cilave një njësi ekonomike ofron përfitime të pas-punësimit për një ose më shumë punonjës.

*Skemat me kontribute të përcaktuara* janë skema të përfitimeve të pas-punësimit në kuadër të të cilave një njësi ekonomike paguan kontribute fikse në një njësi ekonomike tjetër (fond) dhe nuk ka detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar kontribute të tjera nëse fondi nuk mban aktive të mjaftueshme për t'i paguar të gjitha përfitimet e punonjësve që kanë lidhje me shërbimin e punonjësve në periudhën e tanishme dhe periudhat e mëparshme.

*Skemat me përfitime të përcaktuara* janë ato skema të përfitimeve të pas-punësimit që nuk janë skema me kontribute të përcaktuara.

*Skemat me disa punëdhënës* janë skema kontributesh të përcaktuara (ku nuk përfshihen skemat shtetërore) ose skema përfitimesh të përcaktuara (ku nuk përfshihen skemat shtetërore) të cilat:

- (a) grumbullojnë në një vend aktive të kontribuara nga njësi ekonomike të ndryshme të cilat nuk janë nën një kontroll të përbashkët; dhe
- (b) i përdorin këto aktive për të siguruar përfitime për punonjësit e më shumë se një njësie ekonomike, në bazë të faktit që nivelet e kontributeve dhe të përfitimeve përcaktohen pa marrë në konsideratë identitetin e njësisë ekonomike në të cilën punojnë punonjësit në fjalë.

*Përfitime të tjera të punonjësve afatgjata* janë përfitimet e punonjësve (përfashtuar përfitimet e pas-punësimit dhe përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës) të cilat nuk maturohen tërësisht brenda 12 muajsh pas mbylljes së periudhës në të cilën i realizojnë punonjësit shërbimet e lidhura me to.

*Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës* janë përfitime të punonjësve të pagueshme si rezultat i:

- (a) vendimit të një njësie ekonomike për të ndërprerë marrëdhëniet e punës të një punonjësi përpara datës normale të daljes në pension; ose
- (b) vendimit të një punonjësi për të pranuar të largohet vullnetarisht nga vendi i punës në këmbim të këtyre përfitimeve.

*Përfitimet e punonjësve të fituara* janë përfitime të punonjësve të cilat nuk kushtëzohen me marrëdhënie pune të ardhshme.

*Vlera aktuale e një detyrimi përfitimi të përcaktuar* është vlera aktuale, pa zbritur aktivet e skemës, e pagesave të ardhshme të pritura, të kërkuara për shlyerjen e detyrimit që rrjedh nga shërbimi i punonjësve në periudhën e tanishme dhe periudhat e mëparshme.

*Kosto e shërbimit aktual* është rritja e vlerës aktuale të detyrimit për përfitime të përcaktuara që lind nga shërbimi i punonjësve në periudhën aktuale.

*Kosto e interesit* është rritja, gjatë një periudhe, e vlerës aktuale të një detyrimi për përfitime të përcaktuara, e cila lind ngaqë përfitimet i janë afruar me një periudhë shlyerjes.

*Aktivet e skemës* përbëhen nga:

- (a) aktive të mbajtura nga një fond i përfitimeve afatgjata të punonjësve; dhe
- (b) polica kualifikuese sigurimesh.

*Aktive të mbajtura nga një fond i përfitimeve të punonjësve afatgjata* janë aktive (me përjashtim të instrumenteve financiare jo të transferueshme të emetuara nga njësia raportuese) të cilat:

- (a) mbahen nga një njësi ekonomike (fond) e cila është e ndarë ligjërisht nga njësia raportuese dhe ekziston vetëm për të paguar ose për të financuar përfitimet e punonjësve; dhe
- (b) janë në dispozicion për t'u përdorur vetëm për të paguar ose financuar përfitimet e punonjësve, nuk janë në dispozicion të kreditorëve të njësisë raportuese (edhe në rastin e falimentit), dhe nuk mund t'i kthehen njësisë raportuese, me përjashtim të rasteve kur:
  - (i) aktivet e mbetura të fondit mjaftojnë për të përmbushur të gjitha detyrimet e skemës ose të njësisë raportuese të lidhura të përfitimeve të punonjësve; ose
  - (ii) aktivet i kthehen njësisë raportuese për ta rimbursuar atë për përfitimet e punonjësve të cilat janë paguar.

*Një policë sigurimi kualifikuese është një policë sigurimi\* e emtuar nga një sigurveues i cili nuk është palë e lidhur (sipas përkufizimit në SNK 24) e njësisë raportuese, nëse të ardhurat nga policia:*

- (a) mund të përdoren vetëm për të paguar ose financuar përfitimet e punonjësve në bazë të një skeme me përfitime të përcaktuar; dhe
- (b) nuk janë në dispozicion të kreditorëve të njësisë raportuese (edhe në rastin e falimentit) dhe nuk mund t'i kthehen njësisë raportuese, me përjashtim të rasteve kur:
  - (i) të ardhurat përfaqësojnë aktive të tepërta, të cilat nuk i nevojiten policës për të përmbushur të gjitha detyrimet e përfitimeve të punonjësve, që lidhen me të; ose
  - (ii) të ardhurat i kthehen njësisë raportuese për ta rimbursuar atë për përfitimet e punonjësve të cilat janë paguar.

*Vlera e drejtë është shuma me të cilën mund të këmbëhej një aktiv, ose me të cilën mund të shlyhej një pasiv, midis palëve të vullnetshme, të mirëinformuara dhe të palidhura me njëra tjetrën .*

*Kthimi mbi aktivet e skemës janë interesa, dividendë dhe të ardhura të tjera nga aktivet e skemës, së bashku me fitimet apo humbjet e realizuara dhe të porealizuara të aktiveve të skemës, minus kostot e administrimit të skemës dhe minus tatimet e pagueshme nga vetë skema.*

*Fitimet dhe humbjet neto aktuariale përbëhen nga:*

- (a) rregullime të llogarisë së eksperiencës (efektet e diferencave midis hipotezave aktuariale të mëparshme dhe asaj që ka ndodhur në të vërtetë); dhe
- (b) efektet e ndryshimeve në hipotezat aktuariale.

*Kostoja e shërbimit të shkuar është rritja e vlerës aktuale të detyrimit për përfitime të përcaktuara për shërbimin e punëmarrësve gjatë periudhave të mëparshme, e cila në periudhën aktuale rrjedh nga futja ose ndryshimi i përfitimeve të pas-punësimit ose të përfitimeve të tjera afatgjata të punonjësve. Kostoja e shërbimit të shkuar mund të jetë ose pozitive (kur futen ose përmirësohen përfitimet) ose negative (kur pakësohen përfitimet ekzistuese).*

## **Përfitimet e punonjësve afatshkurtra**

- 8 Përfitimet e punonjësve afatshkurtra përfshijnë zëra të tillë si:
- (a) paga, rroga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore;
  - (b) mungesa të kompensuara afatshkurtra (të tilla si leje vjetore e paguar dhe leje shëndetësore e paguar) kur mungesat priten të ndodhin brenda dymbëdhjetë muajve pas mbylljes së periudhës në të cilën e kryejnë shërbimin përkatës punonjësit;
  - (c) pjesëmarrja në fitim dhe shpërblime pune të pagueshme brenda dymbëdhjetë muajve pas mbylljes së periudhës në të cilën e kryejnë shërbimin përkatës punonjësit; dhe
  - (d) përfitime jo monetare (siç janë kujdesi shëndetësor, strehimi, autoveturat dhe mallrat ose shërbimet pa pagesë ose të subvencionuara) për punonjësit aktualë.
- 9 Në përgjithësi, kontabiliteti i përfitimeve të punonjësve afatshkurtra është i thjeshtë sepse nuk kërkohen hipoteza aktuariale për të matur detyrimin ose koston dhe nuk ka mundësi të ketë fitim ose humbje neto aktuariale. Për më tepër, detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve maten të paskontuara.

\* Një policë sigurimi kualifikuese jo me domosdo është një kontratë sigurimi, sikurse përkufizohet në SNRF 4 *Kontratat e sigurimeve*.

## Njohja dhe matja

### Të gjitha përfitimet e punonjësve afatshkurtra

- 10 Kur një punonjës ka kryer shërbim për një njësi ekonomike gjatë një periudhe kontabël, njësi ekonomike njeh vlerën e paskontuar të përfitimeve afatshkurtra të punonjësit që priten të paguhen në këmbim të shërbimit:
- (a) si pasiv (shpenzim i konstatuar), pasi zbritet vlera që është paguar. nëse shuma që është paguar është më e madhe se vlera e paskontuar e përfitimeve, njësi ekonomike e njeh këtë tepriçë si aktiv (shpenzim të parapaguar) për aq sa ky parapagim do të çojë, për shembull, në një zbritje të pagesave të ardhshme ose në një rikthim të parave; dhe
  - (b) si shpenzim, nëse ndonjë Standard tjetër nuk kërkon apo lejon përfshirjen e përfitimeve në koston e një aktivi (për shembull, shih SNK 2 *Inventarët* dhe SNK 16 *Aktivët afatgjatë materiale*).

Paragrafët 11, 14 dhe 17 shpjegojnë se si e zbaton njësi ekonomike këtë kërkesë për përfitimet afatshkurtra të punonjësve në formën e mungesave të kompensuar dhe të skemave të ndarjes së fitimeve dhe të shpërblimeve.

### Mungesat afatshkurtra të kompensuar

- 11 Një njësi ekonomike e njeh koston e shpenzuar të përfitimeve të punonjësve afatshkurtra në formën e mungesave të kompensuar në bazë të paragrafit 10, si më poshtë:
- (a) në rastin e mungesave të akumulueshme të kompensuar, kur punonjësi kryen shërbim që ia rrit të drejtën për mungesa të kompensuar në të ardhmen; dhe
  - (b) në rastin e mungesave jo të akumulueshme të kompensuar, kur ndodh mungesa.
- 12 Një njësi ekonomike mund t'i kompensojë punonjësit për mungesat me arsye të ndryshme, përfshirë pushimet, sëmundjet, paaftësinë e përkohshme, shërbim në juri gjyqësore ose shërbim ushtarak. E drejta për mungesa të kompensuar ndahet në dy kategori:
- (a) të akumulueshme; dhe
  - (b) jo të akumulueshme.
- 13 Mungesa të akumulueshme të kompensuar janë ato mungesa të cilat mbarten dhe mund të përdoren në periudhat e mëvonshme nëse nuk është përdorur plotësisht e drejta që i takon punonjësit për periudhën aktuale. Mungesat e akumulueshme të kompensuar mund të jenë ose të kushtëzuara (me fjalë të tjera, punonjësit e fitojnë të drejtën për një pagesë monetare për të drejtën e papërdorur kur largohen nga njësi ekonomike) ose jo të kushtëzuara (kur punonjësit nuk kanë të drejtë të marrin pagesë monetare për të drejtën e papërdorur kur largohen). Një detyrim krijohet kur punonjësit kryejnë shërbimin që shton të drejtën e tyre për mungesa të kompensuar në të ardhmen. Detyrimi ekziston dhe njihet edhe nëse mungesat e kompensuar janë jo të kushtëzuara, megjithëse në matjen e këtij detyrimi ndikon fakti që punonjësit mund të largohen përpara se të përdorin një të drejtë të akumuluar jo të kushtëzuar.
- 14 Një njësi ekonomike e mat koston e pritur dhe detyrimin për mungesat e akumulueshme të kompensuar me shumën shtesë që pret të paguajë njësi ekonomike si pasojë e akumulimit të kuotës së papërdorur në datën e bilancit.
- 15 Metoda e specifikuar në paragrafin e mësipërm e mat detyrimin me shumën e pagesave shtesë që priten të lindin vetëm nga fakti që përfitimi akumulohet. Në shumë raste, një njësi ekonomike mund të mos ketë nevojë të bëjë llogaritje të hollësishme për të vlerësuar që nuk ka detyrim material për mungesat e kompensuar të papërdorura. Për shembull, një detyrim për mungesat shëndetësore ka të ngjarë të jetë material vetëm nëse dihet zyrtarisht apo jo zyrtarisht që leja shëndetësore e papërdorur mund të përdoret si leje vjetore e paguar.

#### Shembull që ilustron paragrafët 14 dhe 15

Një njësi ekonomike ka 100 punonjës, secili prej të cilëve ka të drejtë të bëjë pesë ditë mungesë shëndetësore të paguar çdo vit. Leja shëndetësore e papërdorur mund të mbartet për një vit kalendarik. Leja shëndetësore në fillim hiqet nga e drejta e vitit aktual dhe pastaj nga teprica e mbartur nga viti i mëparshëm (sipas metodës HFDP- Hyrja e fundit dalja e parë). Më 30 dhjetor 20X1, e drejta e papërdorur mesatare është dy ditë për punonjës. Në bazë të përvojës së shkuar që priten të vazhdojë, njësi ekonomike parashikon që 92 punonjës do të marrin jo më shumë se pesë ditë leje shëndetësore të paguar në vitin 20X2, ndërsa tetë punonjësit e tjerë do të marrin mesatarisht gjashtë ditë e gjysmë secili.

### **Shembull që ilustron paragrafët 14 dhe 15**

*Njësia ekonomike parashikon të paguajë 12 ditë leje shëndetësore shtesë si rezultat i të drejtës së papërdorur të akumuluar më 31 dhjetor 20X1 (një ditë e gjysmë për secilin prej tetë punonjësve). Për rrjedhojë, njësia ekonomike njih një pasiv të barabartë me 12 ditë leje shëndetësore.*

- 16 Mungesat e kompensuara jo të akumulueshme nuk mbarten: ato skadojnë nëse nuk është përdorur tërësisht e drejta e vitit aktual dhe nuk u japin të drejtë punonjësve për të marrë pagesë në mjete monetare për të drejtën e papërdorur kur largohen nga njësia ekonomike. Zakonisht, një gjë e tillë ndodh me pagesën e lejes shëndetësore (për aq sa e drejta e shkuar e papërdorur nuk e rrit të drejtën e ardhshme), lejes së lindjes dhe mungesat e kompensuara për shërbimin në juri gjyqësore ose për shërbimin ushtarak. Njësia ekonomike nuk njih pasiv apo shpenzim deri në momentin e mungesës, sepse shërbimi i punonjësve nuk e rrit shumën e përfitimit.

### **Pjesëmarrja në fitime dhe skemat e shpërblimeve**

- 17 Një njësi ekonomike njih koston e pritur të ndarjes së fitimeve dhe pagesave të shpërblimeve sipas paragrafit 10, atëherë dhe vetëm atëherë kur:

- (a) njësia ekonomike ka një detyrim ligjor ose konstruktiv aktual për t'i bërë këto pagesa si pasojë e ngjarjeve në të kaluarën; dhe
- (b) mund të bëhet një çmuarje e besueshme e detyrimit.

**Një detyrim aktual ekziston atëherë dhe vetëm atëherë kur njësia ekonomike nuk ka alternativë tjetër reale përveç se të kryejë pagesat.**

- 18 Në kuadër të disa skemave të ndarjes së fitimit, punonjësit marrin një pjesë të fitimit vetëm nëse qëndrojnë në njësinë ekonomike për një periudhë të përcaktuar. Skema të tilla krijojnë një detyrim konstruktiv, kur punonjësit kryejnë shërbimin, i cili e rrit shumën që duhet paguar nëse ata nuk largohen nga njësia ekonomike deri në fund të periudhës së përcaktuar. Matja e detyrimeve të tilla konstruktive pasqyron mundësinë që disa prej punonjësve mund të largohen pa i marrë pagesat e pjesëmarrjes në fitime.

### **Shembull që ilustron paragrafin 18**

Një skemë e pjesëmarrjes në fitime kërkon që një njësi ekonomike t'u paguajë një pjesë të përcaktuar të fitimit të vitit punonjësve, të cilët kanë shërbyer gjatë gjithë vitit. Nëse nuk është larguar asnjë punonjës gjatë vitit, shumat gjithsej e pagesave të ndarjes së fitimit për vitin do të jetë 3% e fitimit. Njësia ekonomike çmon se qarkullimi i personelit do ta ulë këtë shumë të pagesave në 2,5% të fitimit.

*Njësia ekonomike njih një pasiv dhe një shpenzim prej 2,5% të fitimit.*

- 19 Një njësi ekonomike mund të mos ketë asnjë detyrim ligjor për të dhënë shpërblime të performancës. Megjithatë, në disa raste, një njësi ekonomike e ka si praktikë që të japë shpërblime të tilla. Në këto raste, njësia ekonomike ka një detyrim konstruktiv, sepse nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç se ta japë shpërblimin. Matja e detyrimit konstruktiv pasqyron mundësinë që disa prej punonjësve mund të largohen pa e marrë shpërblimin.
- 20 Një njësi ekonomike mund të bëjë një çmuarje të besueshme të detyrimit ligjor ose konstruktiv në kuadër të skemës së pjesëmarrjes në fitime ose të shpërblimeve, atëherë dhe vetëm atëherë, kur:
- (a) kushtet formale të skemës përmbajnë një formulë për përcaktimin e vlerës së përfitimit;
  - (b) njësia ekonomike i përcakton shumat që duhet të paguajë përpara se të autorizohet publikimi i pasqyrave financiare; ose
  - (c) praktika e të kaluarës jep evidencë të qartë për shumën e detyrimit konstruktiv të njësisë ekonomike.
- 21 Detyrimi në kuadër të skemave të ndarjes së fitimeve dhe të shpërblimeve lind vetëm nga shërbimi i punonjësit dhe jo nga një transaksion me pronarët e njësisë ekonomike. Për rrjedhojë, një njësi ekonomike e njih koston e skemave të ndarjes së fitimeve dhe të shpërblimeve jo si shpërndarje të fitimit por si shpenzim.
- 22 Nëse pagesat e ndarjes së fitimeve dhe të shpërblimeve nuk maturohen tërësisht brenda 12 muajve pas mbylljes së periudhës, në të cilën e realizojnë punonjësit shërbimin e lidhur me to, këto pagesa janë përfitime të tjera afatgjata të punonjësve (shih paragrafët 126-131).

## Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 23 Edhe pse ky Standard nuk kërkon informacione specifike shpjeguese për përfitimet afatshkurtra të punonjësve, informacione të tilla mund të kërkojnë nga Standarde të tjera. Për shembull, SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura*, kërkon dhënie të informacioneve shpjeguese për përfitimet e punonjësve për personelin drejtues kryesor. SNK 1 *Paraqitja e pasqyrave financiare*, kërkon dhënie të informacioneve shpjeguese për përfitimet e punonjësve.

## Përfitime e pas-punësimit: dallimi midis skemave me kontribute të përcaktuara dhe skemave me përfitime të përcaktuara

---

- 24 Përfitimet e pas-punësimit përfshijnë, për shembull:
- (a) përfitimet e largimit nga puna, siç janë pensionet; dhe
  - (b) përfitime të tjera pas përfundimit të marrëdhënieve të punës, siç janë sigurimi i jetës pas përfundimit të marrëdhënieve të punës dhe kujdesi shëndetësor pas përfundimit të marrëdhënieve të punës.
- Mënyra përmes së cilës i jep përfitimet e pas-punësimit një njësi ekonomike janë skemat e përfitimeve të pas-punësimit. Një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për të gjitha këto skema, pavarësisht faktit nëse kërkohet apo jo krijimi i një njësie ekonomike më vete për të marrë kontributet dhe për të paguar përfitimet.
- 25 Skemat e përfitimeve të pas-punësimit klasifikohen ose si skema me kontribute të përcaktuara ose si skema me përfitime të përcaktuara, në varësi të përmbajtjes ekonomike të skemës që buron nga termit dhe kushtet kryesore të saj. Në kuadër të skemave me kontribute të përcaktuara:
- (a) detyrimi ligjor ose konstruktiv i njësisë ekonomike është i kufizuar me shumën që ajo pranon të futë si kontribut në fond. Pra, shuma e përfitimeve të pas-punësimit, të marra nga punonjësi, përcaktohet përmes vlerës së kontributeve që ka paguar një njësi ekonomike (dhe mbase, edhe punonjësi) në një skemë të përfitimeve të pas-punësimit ose në një shoqëri sigurimesh, së bashku me kthimet e investimit që lindin nga këto kontribute; dhe
  - (b) për rrjedhojë, rreziku aktuarial (që përfitimet do të jenë më të vogla nga sa priten) dhe rreziku i investimit (që aktivet do të jenë të pamjaftueshme për të përmbushur përfitimet e pritura) bien mbi punonjësin.
- 26 Shembujt e rasteve, kur detyrimi i njësisë ekonomike nuk është i kufizuar me shumën që ajo pranon të futë si kontribut në fond, janë kur njësia ekonomike ka një detyrim ligjor ose konstruktiv përmes:
- (a) një formule të përfitimeve të skemës, e cila nuk është e lidhur vetëm me vlerën e kontributeve;
  - (b) një garancie, ose indirekt përmes një skeme ose drejtpërdrejt, të një kthimi të përcaktuar mbi kontributet; ose
  - (c) atyre praktikave joformale, të cilat lindin një detyrim konstruktiv. Për shembull, një detyrim konstruktiv mund të lindë kur një njësi ekonomike ka një histori të rritjes së përfitimeve të punonjësve të mëparshëm për të ruajtur të njëjtin nivel me inflacionin edhe atëherë kur nuk ka një detyrim ligjor për të vepruar kështu.
- 27 Në kuadër të skemave me përfitime të përcaktuara:
- (a) detyrimi i njësisë ekonomike është t'u japë punonjësve të tanishëm dhe të mëparshëm përfitimet, për të cilat është rënë dakort; dhe
  - (b) rreziku aktuarial (që përfitimet do të kushtojnë më shumë nga sa pritet) dhe rreziku i investimeve, në thelb, bie mbi njësine ekonomike. Nëse përvoja aktuariale ose e investimeve është më e keqe nga sa pritet, detyrimi i njësisë ekonomike mund të rritet.
- 28 Paragrafët 29-42 më poshtë, shpjegojnë dallimin midis skemave me kontribute të përcaktuara dhe skemave me përfitime të përcaktuara, në kushtet e skemave me disa punëdhënës, të skemave shtetërore dhe të përfitimeve të siguruara.

## Skemat me disa punëdhënës

- 29 Një njësi ekonomike e klasifikon një skemë me disa punëdhënës si skemë me kontribute të përcaktuara ose si skemë me përfitime të përcaktuara, sipas kushteve të skemës (përfshirë edhe çdo detyrim konstruktiv që shkon përtej kushteve formale). Kur skema me disa punëdhënës është skemë me përfitime të përcaktuara, njësia ekonomike:

- (a) kontabilizon pjesën e vet të detyrimit për përfitimet e përcaktuara, aktivet e skemës dhe kostot që kanë të bëjnë me skemën, njësoj sikurse edhe për çdo skemë tjetër me përfitime të përcaktuara; dhe
- (b) bën të ditur informacionin e kërkuar në paragrafin 120A.
- 30 Kur nuk ka informacion të mjaftueshëm për të përdorur kontabilizimin e përfitimeve të përcaktuara për një skemë me përfitime të përcaktuara me disa punëdhënës, atëherë njësia ekonomike:
- (a) e kontabilizon skemën sipas paragrafëve 44-46 sikur të jetë skemë me kontribute të përcaktuara;
- (b) jep informacion shpjegues për:
- (i) faktin që skema është një skemë me përfitime të përcaktuara; dhe
- (ii) arsyen përse nuk ka informacion të mjaftueshëm për t'i dhënë mundësi njësisë ekonomike ta kontabilizojë skemën si skemë me përfitime të përcaktuara; dhe
- (c) për aq sa suficiti apo deficitin në skemë e prek shumën e kontributeve të ardhshme, jep informacione shpjeguese edhe për:
- (i) çdo informacion që ka për këtë suficit apo deficit;
- (ii) bazën e përdorur për të përcaktuar suficitin apo deficitin; dhe
- (iii) rrjedhojat për njësinë ekonomike, nëse ka.
- 31 Një shembull i një skeme me përfitime të përcaktuara me disa punëdhënës është kur:
- (a) skema financohet mbi bazën “pay as you go” në mënyrë të tillë që: kontributet caktohen në një nivel, që pritet të jetë i mjaftueshëm për të paguar përfitimet që maturohen në po atë periudhë; çdo përfitim i ardhshëm i fituar gjatë periudhës aktuale do të paguhet me anë të kontributeve të ardhshme; dhe
- (b) përfitimet e punonjësve përcaktohen nga kohëzgjatja e shërbimit të tyre dhe njësiti ekonomike pjesëmarrëse nuk kanë mënyra realiste tërheqjeje nga skema pa paguar një kontribut për përfitimet e fituara nga punonjësit deri në datën e tërheqjes. Një skemë e tillë krijon një rrezik aktuarial për njësinë ekonomike: Nëse kostoja përfundimtare e përfitimeve të fituara në datën e bilancit, është më e madhe nga sa pritej, njësiti ekonomike do t'i duhet ose t'i rrisë kontributet ose t'i bindë punonjësit të pranojnë një zvogëlim të përfitimeve. Pra, një skemë e tillë është skemë me përfitime të përcaktuara.
- 32 Kur ka informacion të mjaftueshëm për një skemë me disa punëdhënës, e cila është skemë me përfitime të përcaktuara, njësia ekonomike e kontabilizon pjesën e vet të detyrimit për përfitime të përcaktuara, të aktiveve të skemës dhe të kostos së përfitimeve të pas-punësimit të lidhura me skemën, njësoj si për çdo skemë tjetër me përfitime të përcaktuara. Megjithatë, në disa raste, një njësi ekonomike mund të mos e identifikojë dot pjesën e vet të pozicionit financiar dhe të rezultatit të skemës me besueshmëri të mjaftueshme për qëllime kontabël. Kjo mund të ndodhë nëse:
- (a) njësia ekonomike nuk ka akses në informacionin rreth skemës, që përmbush kërkesat e këtij Standardi; ose
- (b) skema i ekspozon njësiti ekonomike pjesëmarrëse ndaj rreziqeve aktuariale që kanë të bëjnë me punonjësit ekzistues dhe të mëparshëm të njësive ekonomike të tjera, dhe si rezultat, nuk ka një bazë të njëtrajtshme dhe të besueshme për ta shpërndarë detyrimin, aktivet e skemës dhe kostot tek njësiti ekonomike të veçanta që marrin pjesë në skemë.
- Në këto raste, njësia ekonomike e kontabilizon skemën sikur të ishte skemë me kontribute të përcaktuara dhe jep informacionet shpjeguese që kërkohen paragrafi 30.
- 32A Mund të ketë një akt-marrëveshje midis skemës me disa punëdhënës dhe pjesëmarrësve të saj, që përcakton mënyrën e shpërndarjes të suficitit tek pjesëmarrësit (ose të financimit të deficitit). Një pjesëmarrës në një skemë me disa punëdhënës me një akt-marrëveshje të tillë, i cili e kontabilizon skemën si skemë me kontribute të përcaktuara në përputhje me paragrafin 30, duhet të njohë aktivin ose pasivin që lind nga akt-marrëveshja, si edhe të ardhurat ose shpenzimet përkatëse, në fitim ose humbje.

#### **Shembull që ilustron paragrafin 32A**

Një njësi ekonomike merr pjesë në një skemë me disa punëdhënës me përfitime të përcaktuara, e cila nuk përgatit vlerësimet e skemës sipas SNK 19. Për rrjedhojë, ajo e kontabilizon skemën sikur të jetë skemë me kontribute të përcaktuara. Një vlerësim i financimit, i kryer jo sipas SNK 19, tregon një deficit prej 100 milionësh në skemë. Në bazë të një kontrate, skema ka rënë dakort për një grafik kontributesh me punëdhënësit pjesëmarrës në skemë për ta eliminuar deficitin gjatë pesë vjetëve të ardhshme. Kontributet gjithsej të njësiti ekonomike në bazë të kontratës janë 8 milion.

### **Shembull që ilustron paragrafin 32A**

*Njësia ekonomike njeh një pasiv për kontributet të rregulluar me vlerën në kohë të parasë dhe një shpenzim të barabartë me të, në fitim ose humbje.*

- 32B SNK 37 *Provizionet, pasivet e kushtëzuara dhe aktivet e kushtëzuara*, i kërkon njësisë ekonomike të njohë ose të japë informacione shpjeguese për disa pasive të kushtëzuara të caktuara. Në kushtet e një skeme me disa punëdhënës, një pasiv i kushtëzuar mund të lindë, për shembull, nga:
- (a) humbjet aktuariale neto që lidhen me njësitë e tjera ekonomike pjesëmarrëse, sepse secila njësi ekonomike, që merr pjesë në një skemë me disa punëdhënës, merr pjesë në rreziqet aktuariale të çdo njësie ekonomike tjetër pjesëmarrëse; ose
  - (b) çdo përgjegjësi që rrjedh nga kushtet e skemës për të financuar deficitin e skemës nëse pushojnë së marri pjesë njësitë e tjera ekonomike.
- 33 Skemat me disa punëdhënës dallojnë nga skemat e administrimit në grup. Skema e administrimit në grup është thjesht një agregim i skemave me një punëdhënës, të cilat bashkohen për t'u dhënë mundësi punëdhënësve për t'i bashkuar aktivet e tyre për qëllime investimi dhe për të zvogëluar kostot e menaxhimit dhe administrimit të investimeve, por ndërkohë, kërkesat e punëdhënësve mbahen të veçuara në mënyrë që prej tyre të përfitojnë vetëm punëmarrësit përkatës. Skemat e administrimit në grup nuk paraqesin ndonjë problem të veçantë kontabiliteti sepse ka informacion të gatshëm për t'i trajtuar ato në të njëjtën mënyrë sikurse edhe çdo skemë tjetër me një punonjës, dhe sepse skema të tilla nuk paraqesin për njësitë ekonomike pjesëmarrëse ndonjë rrezik aktuarial në lidhje me punonjësit ekzistues dhe të mëparshëm të njësive ekonomike të tjera. Përkufizimet që jepen në këtë Standard i kërkojnë njësisë ekonomike ta klasifikojë një skemë të administrimit në grup si skemë me kontribute të përcaktuara ose skemë me përfitime të përcaktuara sipas kushteve të skemës (përfshirë edhe çdo detyrim konstruktiv që shkon përtej kushteve formale).

### **Skemat me përfitime të përcaktuara të cilat e shpërndajnë rrezikun midis disa njësive ekonomike nën kontroll të përbashkët**

- 34 Skemat me përfitime të përcaktuara të cilat e shpërndajnë rrezikun mes disa njësive ekonomike nën kontroll të përbashkët, për shembull një shoqëri mëmë dhe filialet e veta, nuk janë skema me disa punëdhënës.
- 34A Një njësi ekonomike që merr pjesë në një skemë të tillë, duhet të marrë informacion për skemën si të tërë, të matur në përputhje me SNK 19, në bazë të supozimeve që aplikohen për skemën në tërësi. Nëse ka një akt-marrëveshje ose një politikë të shprehur për t'ua ngarkuar koston e përfitimeve të përcaktuara neto për skemën si të tërë, të matur në përputhje me SNK 19, njësive ekonomike individuale të grupit, njësia ekonomike, në pasqyrat financiare individuale, njeh koston e përfitimeve të përcaktuara neto të ngarkuar. Nëse nuk ka një akt-marrëveshje apo politikë të tillë, kostoja e përfitimeve të përcaktuara neto njihet në pasqyrat financiare individuale të njësive ekonomike të grupit, e cila është ligjërisht mbështetësi financiar i skemës. Njësitë e tjera ekonomike të grupit, në pasqyrat financiare individuale, njohin një kosto të barabartë me kontributet e tyre të pagueshme për periudhën.
- 34B Pjesëmarrja në një skemë të tillë është një transaksion me palë të lidhura për secilën njësi ekonomike të grupit. Për rrjedhojë, njësia ekonomike, në pasqyrat financiare individuale, jep këto informacione shpjeguese:
- (a) akt-marrëveshjen ose politikën e shprehur për ngarkimin e koston të përfitimeve të përcaktuara neto ose faktin që nuk ka një politikë të tillë.
  - (b) politikën për përcaktimin e kontributit që duhet të paguajë njësia ekonomike.
  - (c) nëse njësia ekonomike kontabilizon një shpërndarje të koston të përfitimeve të përcaktuara neto në përputhje me paragrafin 34A, të gjithë informacionin për skemën në tërësi, në përputhje me paragrafët 120-121.
  - (d) nëse njësia ekonomike kontabilizon kontributin e pagueshëm për periudhën në përputhje me paragrafin 34A, informacionin për skemën në tërësi, që kërkohet në përputhje me paragrafët 120A(b)-(e), (j), (n), (o), (q) dhe 121. Nuk kërkohen informacionet e tjera shpjeguese që kërkon paragrafi 120A.
- 35 [Fshirë]



## Skemat shtetërore

- 36 **Një njësi ekonomike e kontabilizon skemën shtetërore njësoj me skemën me disa punëdhënës (shih paragrafët 29 dhe 30).**
- 37 Skemat shtetërore krijohen me ligj për të mbuluar të gjitha njësitë ekonomike (ose të gjitha njësitë ekonomike të një kategorie të veçantë, për shembull të një industrie të veçantë) dhe administrohen nga pushteti qendror ose vendor, ose nga një organ tjetër (për shembull, një agjenci autonome e krijuar posaçërisht për këtë qëllim) që nuk është nën kontrollin apo influencën e njësisë ekonomike raportuese. Disa skema të krijuara nga një njësi ekonomike japin si përfitime të detyrueshme, që jepen në vend të përfitimeve që do mbulohehin nga një skemë shtetërore, ashtu edhe përfitime vullnetare. Këto skema nuk janë skema shtetërore.
- 38 Skemat shtetërore karakterizohen si skema me përfitime të përcaktuara ose skema me kontribute të përcaktuara për nga natyra, në bazë të detyrimit që ka njësia ekonomike në kuadër të skemës. Shumë skema shtetërore financohen mbi bazën “pay as you go” (paguaj aq sa ke): në këtë rast, kontributet caktohen në nivelin që pritet të jetë i mjaftueshëm për të paguar përfitimet e kërkuara që maturohen në po atë periudhë; çdo përfitim i ardhshëm i fituar gjatë periudhës aktuale do të paguhet me anë të kontributeve të ardhshme. Megjithatë, në shumë skema shtetërore, njësia ekonomike nuk e ka detyrimin ligjor apo konstruktiv për t’i paguar këto përfitime të ardhshme: detyrimi i vetëm që ka është të paguajë detyrimet kur janë të pagueshme dhe kur njësia ekonomike ndërpret marrëdhëniet e punës me anëtarët e skemës shtetërore, ajo nuk ka më detyrimin për të paguar përfitimet e fituara nga punonjësit e vet gjatë viteve të mëparshme. Për këtë arsye, skemat shtetërore, zakonisht, janë skema me kontribute të përcaktuara. Megjithatë, në ato raste të pakta kur një skemë shtetërore është skemë me përfitime të përcaktuara, njësia ekonomike aplikon trajtimin e përcaktuar në paragrafët 29 dhe 30.

## Përfitimet e siguruara

- 39 **Një njësi ekonomike mund të paguajë prime sigurimi për të financuar një skemë përfitimesh të pas-punësimit. Këtë skemë njësia ekonomike e trajton si skemë me kontribute të përcaktuara, nëse njësia ekonomike nuk ka detyrimin ligjor ose konstruktiv (drejtpërdrejt ose indirekt, përmes skemës) për:**
- (a) për t’ua paguar punonjësve përfitimet drejtpërdrejt kur maturohen; ose
  - (b) për të paguar shumën të tjera nëse siguroesi nuk i paguan të gjitha përfitimet e ardhshme të punonjësve, që lidhen me shërbimin e punonjësve në periudhën aktuale dhe ato të mëparshme.
- Nëse njësia ekonomike e ruan një detyrim të tillë ligjor ose konstruktiv, ajo e trajton skemën si skemë me përfitime të përcaktuara.**
- 40 Nuk është nevoja që përfitimet e siguruara me anë të një kontrate sigurimi të kenë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë apo automatike me detyrimin e njësisë ekonomike për përfitimet e punonjësve. Skemat e përfitimeve të pas-punësimit që kërkojnë kontrata sigurimi i nënshtrohen të njëjtit dallim midis kontabilitetit dhe financimit sikurse edhe skemat e tjera të financuara.
- 41 Kur një njësi ekonomike financon një detyrim për përfitime të pas-punësimit përmes kontributit në një police sigurimi në kuadër të së cilës njësia ekonomike (drejtpërdrejt, ose indirekt përmes skemës, përmes mekanizmit për vendosjen e primeve të ardhshme ose përmes një marrëdhënieje me siguroesin si palë e lidhur) ruan një detyrim ligjor ose konstruktiv, pagimi i primeve nuk përbën një skemë me kontribute të përcaktuara. Në këtë rast njësia ekonomike:
- (a) e kontabilizon një policë sigurimi kualifikuese si një aktiv të skemës (shih paragrafin 7); dhe
  - (b) i njeh policat e tjera të sigurimit si të drejta rimbursimi (nëse policat plotësojnë kriteret e paragrafit 104A).
- 42 Kur një policë sigurimi është në emër të një pjesëmarrësi të specifikuar të skemës ose të një grupi të pjesëmarrësve të skemës dhe njësia ekonomike nuk ka detyrimin ligjor ose konstruktiv për të mbuluar humbjet nga polica, njësia ekonomike nuk ka asnjë detyrim për t’ua paguar përfitimet punonjësve dhe përgjegjësinë e vetme për t’i paguar përfitimet e ka siguroesi. Pagimi i primeve fikse në kuadër të kontratave të tilla, në thelb është një shlyerje e detyrimit për përfitimet e punonjësve dhe jo një investim për ta përmbushur detyrimin. Kështu, njësia ekonomike nuk ka më një aktiv apo një pasiv. Për rrjedhojë, njësia ekonomike i trajton pagesa të tilla si kontribute që futen në skemën me kontribute të përcaktuara.

## Përfitimet e pas-punësimit: skemat me kontribute të përcaktuara

- 43 Kontabilizimi i skemave me kontribute të përcaktuara nuk është i komplikuar sepse detyrimi i njësisë raportuese për secilën periudhë përcaktohet nga shumat që duhen dhënë si kontribut për këtë periudhë. Po kështu, nuk kërkojnë hipoteza aktuariale për të matur detyrimin ose shpenzimin dhe nuk ka mundësi të ketë fitim ose humbje

neto aktuariale. Për më tepër, detyrimet maten të paskontuara, me përjashtim të rastit kur nuk maturohen tërësisht brenda 12 muajsh pas mbylljes së periudhës në të cilën e realizojnë punonjësit shërbimin e lidhur me to.

## Njohja dhe matja

- 44 Kur një punonjës i ka shërbyer një njësie ekonomike gjatë një periudhe, njësia ekonomike duhet të njohë kontributet e pagueshme në një skemë me kontribute të përcaktuara në këmbim të këtij shërbimi:
- (a) si pasiv (shpenzim i konstatuar), pasi zbritet kontributi që është paguar. Nëse kontributi që është paguar është më i madh se kontributi që duhet paguar për shërbimin përpara datës së blinacit, njësia ekonomike e njuh këtë teprice si aktiv (shpenzim të parapaguar) për aq sa ky parapagim do të çojë, për shembull, në një zbritje të pagesave të ardhshme ose në një rikthim të parave; dhe
  - (b) si shpenzim, nëse ndonjë Standard tjetër nuk kërkon apo lejon përfshirjen e kontributeve në koston e një aktivi (për shembull, shih SNK 2 *Inventarët* dhe SNK 16 *Aktivet afatgjata materiale*).
- 45 Kur kontributet e një skeme me kontribute të përcaktuara nuk maturohen tërësisht brenda 12 muajve pas mbylljes së periudhës në të cilën i realizojnë punonjësit shërbimet e lidhura me to, ato skontohen duke përdorur normën e skontimit të specifikuar në paragrafin 78.

## Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 46 Një njësi ekonomike duhet të bëjë të ditur shumën e njohur si shpenzim për skemat me kontribute të përcaktuara.
- 47 Kur e kërkon SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura*, njësia ekonomike jep informacion për kontributet e dhëna në skemën me kontribute të përcaktuara për personelin drejtues kryesor.

## Përfitimet e pas-punësimit: skemat me përfitime të përcaktuara

---

- 48 Kontabilizimi i skemave me përfitime të përcaktuara është kompleks, sepse kërkohen hipoteza aktuariale për të matur detyrimin dhe shpenzimin, dhe ekziston një mundësi për fitime dhe humbje neto aktuariale. Për më tepër, detyrimet maten mbi një bazë të skontuar sepse mund të shlyhen shumë vjet pasi t'i kanë kryer punonjësit shërbimin e lidhur me to.

## Njohja dhe matja

- 49 Skemat me përfitime të përcaktuara mund të jenë të pafinancuara, ose mund të financohen tërësisht ose pjesërisht me kontribute nga një njësi ekonomike dhe ndonjëherë, edhe nga punonjësit e saj, që i jepen një njësie ekonomike, ose nga fondi i cili ligjërisht është i ndarë nga njësia ekonomike raportuese dhe, nga e cila paguhen përfitimet e punonjësve. Pagesa e përfitimeve të financuara kur maturohen, varet jo vetëm nga pozicioni financiar dhe performanca e investimeve të fondit por edhe nga aftësia (dhe vullneti) e njësisë ekonomike për të mbuluar ndonjë diferencë në aktivet e fondit. Për rrjedhojë, në thelb, njësia ekonomike pranon rreziqet aktuariale dhe të investimit që lidhen me skemën. Kështu, shpenzimi i njohur për një skemë me përfitime të përcaktuara jo me domosdo është shuma e kontributit që duhet paguar për periudhën.
- 50 Kontabilizimi që u bën një njësi ekonomike skemave me përfitime të përcaktuara kërkon këto hapa:
- (a) përdorimi i teknikave aktuariale për të bërë një çmuarje të besueshme të shumës së përfitimit që kanë fituar punonjësit në këmbim të shërbimit të tyre në periudhën aktuale dhe ato të mëparshme. Kjo i kërkon një njësie ekonomike të përcaktojë se sa përfitim u ngarkohet periudhave të mëparshme dhe asaj ekzistuese (shih paragrafët 67-71) dhe të bëjë çmuarje (hipoteza aktuariale) në lidhje me variablat demografike (si për shembull, qarkullimi dhe vdekshmëria e punonjësve) dhe variablat financiare (si për shembull, rritjet e ardhshme të pagave dhe kostove mjekësore) të cilat do të kenë ndikim në koston e përfitimit (shih paragrafët 72-91);
  - (b) skontimi i këtij përfitimi duke përdorur metodën e kreditimit për njësi të projektuar për të përcaktuar vlerën aktuale të detyrimit për përfitimet e përcaktuara dhe koston aktuale të shërbimit (shih paragrafët 64-66);
  - (c) përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve të skemës (shih paragrafët 102-104);
  - (d) përcaktimi i shumës gjithsej të fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale dhe i shumës së fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale që do të njihen (shih paragrafët 92-95);

- (e) kur është futur ose është ndryshuar një skemë, përcaktimi i kostos së shërbimit të shkuar (shih paragrafët 96-101); dhe
- (f) kur është reduktuar ose është shlyer një skemë, përcaktimi i fitimit ose humbjes përkatëse (shih paragrafët 109-115).

Kur një njësi ekonomike ka më shumë se një skemë me përfitime të përcaktuara, njësia ekonomike i aplikon këto procedura veças për secilën skemë materiale.

- 51 Në disa raste, çmuarjet, mesataret dhe llogaritjet e shkurtuara mund të ofrojnë një përafrim të besueshëm të llogaritjeve të hollësishme të ilustruara në këtë Standard.

## **Kontabilizimi i detyrimit konstruktiv**

- 52 Një njësi ekonomike kontabilizon jo vetën detyrimin e vet ligjor që rrjedh nga kushtet formale të një skeme me përfitime të përcaktuara, por edhe çdo detyrim konstruktiv që lind nga praktikatat e njësisë ekonomike. Praktikatat joformale sjellin një detyrim konstruktiv atëherë kur njësia ekonomike nuk ka alternativë tjetër realiste përveç se t'i paguajë përfitimet e punonjësve. Shembull i një detyrimi konstruktiv është kur një ndryshim i praktikave joformale të njësisë ekonomike do të shkaktonte një dëm të papranueshëm ndaj marrëdhënieve të saj me punonjësit.
- 53 Kushtet formale të një skeme me përfitime të përcaktuara mund t'ia lejojnë një njësie ekonomike t'i japë fund detyrimit të vet në kuadër të skemës. Megjithatë, për një njësi ekonomike zakonisht është e vështirë që ajo të anulohet një skemë, kur punonjësit duhen mbajtur. Për rrjedhojë, në mungesë të informacionit që provon të kundërtën, kontabilizimi i përfitimeve të pas-punësimit merr si të mirëqënë faktin, që një njësi ekonomike e cila aktualisht është duke premtuar përfitime të tilla, do të vazhdojë të veprojë kështu, edhe për pjesën tjetër të jetës aktive në punë të punonjësve.

## **Bilanci**

- 54 Shuma e njohur si pasiv për përfitime të përcaktuara është shuma gjithsej neto e këtyre vlerave:
- (a) vlera aktuale e detyrimit për përfitime të përcaktuara në datën e bilancit (shih paragrafin 64);
  - (b) plus fitimet neto aktuariale (minus humbjet neto aktuariale) që nuk janë njohur për shkak të trajtimit të parashikuar në paragrafët 92 dhe 93;
  - (c) minus kostot e shërbimit të shkuar që nuk është njohur ende (shih paragrafin 96);
  - (d) minus vlerën e drejtë në datën e bilancit të aktiveve të skemës (nëse ka) nga të cilat do të shlyhen drejtpërdrejt detyrimet (shih paragrafët 102-104).
- 55 Vlera aktuale e detyrimit për përfitime të përcaktuara është detyrimi bruto, përpara se të zbritet vlera e drejtë e aktiveve të skemës.
- 56 Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë vlerën aktuale të detyrimeve për përfitime të përcaktuara dhe vlerën e drejtë të çdo aktivi të skemës me rregullsi të mjaftueshme në mënyrë që vlerat e njohura në pasqyrat financiare të mos ndryshojnë në mënyrë materiale nga vlerat që do të përcaktoheshin në datën e bilancit.
- 57 Ky Standard inkurajon, por nuk e kërkon, që një njësi ekonomike të angazhojë një aktuar të kualifikuar në menaxhimin e të gjitha detyrimeve me rëndësi materiale për përfitimet e pas-punësimit. Për arsye praktike, një njësi ekonomike mund t'i kërkojë një aktuari të kualifikuar të kryejë një vlerësim të hollësishëm të detyrimit përpara datës së bilancit. Pavarësisht kësaj, rezultatet e këtij vlerësimi aktualizohen për çdo transaksion me rëndësi materiale dhe për të gjitha ndryshimet e tjera me rëndësi materiale të kushteve (përfshirë edhe ndryshimet e normave të interesit dhe të çmimeve në treg) deri më datën e bilancit.
- 58 Vlera e përcaktuar sipas paragrafit 54 mund të jetë negative (një aktiv). Një njësi ekonomike e mat aktivin që del nga ky proces me vlerën më të vogël midis:
- (a) vlerës së përcaktuar sipas paragrafit 54; dhe
  - (b) shumës gjithsej të:
    - (i) humbjeve neto aktuariale të panjohura dhe kostos së shërbimit të shkuar (shih paragrafët 92, 93 dhe 96); dhe
    - (ii) vlerës aktuale të përfitimeve ekonomike të gatshme në formën e kthimeve të fondeve nga skema ose të uljeve të kontributeve të ardhshme në skemë. Vlera aktuale e këtyre përfitimeve ekonomike duhet të përcaktohet duke përdorur normën e skontimit të specifikuar në paragrafin 78.

- 58A** Aplikimi i paragrafit 58 nuk duhet të çojë në njohjen e një fitimi neto vetëm si rezultat i një humbjeje aktuariale ose i kostos së shërbimit të shkuar në periudhën aktuale ose në njohjen e një humbjeje vetëm si rezultat i një fitimi aktuarial në periudhën aktuale. Për rrjedhojë, njësia ekonomike njihet menjëherë sipas paragrafit 54, për aq sa ato linden gjatë përcaktimit të aktivitetit për përfitime të përcaktuara në përputhje me paragrafin 58(b):
- (a) humbjet neto aktuariale të periudhës aktuale dhe koston e shërbimit të shkuar në periudhën aktuale për pjesën me të cilën ato janë më të mëdha se rënia e vlerës aktuale të përfitimeve ekonomike të specifikuara në paragrafin 58(b)(ii). Nëse nuk ka ndryshim apo rritje të vlerës aktuale të përfitimeve ekonomike, të gjitha humbjet neto aktuariale të periudhës aktuale dhe kosto e shërbimit të shkuar në periudhën aktuale njihet menjëherë sipas paragrafit 54.
  - (b) fitimet neto aktuariale të periudhës aktuale, pasi zbritet kosto e shërbimit të shkuar në periudhën aktuale për pjesën me të cilën ato janë më të mëdha se rritja e vlerës aktuale të përfitimeve ekonomike të specifikuara në paragrafin 58(b)(ii). Nëse nuk ka ndryshim apo rënie të vlerës aktuale të përfitimeve ekonomike, të gjitha fitimet neto aktuariale të periudhës aktuale dhe kosto e shërbimit të shkuar në periudhën aktuale njihet menjëherë sipas paragrafit 54.
- 58B** Paragrafi 58A aplikohet për një njësi ekonomike vetëm nëse, në fillim apo në fund të periudhës kontabël, ka një suficit\* në një skemë me përfitime të përcaktuara dhe, në bazë të kushteve ekzistuese të skemës, nuk mund ta rikuperojë tërësisht këtë suficit përmes rikthimit të fondeve apo përmes uljes së kontributeve të ardhshme. Në raste të tilla, kostoja e shërbimit të shkuar dhe humbjet aktuariale që linden gjatë periudhës, njohja e të cilave shtyhet në kohë sipas paragrafit 54, e rrit shumën e specifikuar në paragrafin 58(b)(i). Nëse kjo rritje nuk kompensohet përmes një zvogëlimi të barabartë të vlerës aktuale të përfitimeve të ardhshme të cilat i plotësojnë kushtet e njohjes sipas paragrafit 58(b)(i), ka një rritje të shumës neto gjithsej të specifikuar në paragrafin 58(b) dhe, për rrjedhojë, ka një fitim neto të njohur. Paragrafi 58A e ndalon njohjen e një fitimi në këto rrethana. Një efekt i kundërt lind në lidhje me fitimet aktuariale të cilat linden gjatë periudhës, njohja e të cilave shtyhet në kohë në bazë të paragrafit 54, për aq sa fitimet aktuariale i ulin humbjet aktuariale të panjohura të akumuluar. Paragrafi 58A ndalon njohjen e një humbjeje në këto rrethana. Për disa shembuj të aplikimit të këtij paragrafi, shih Shtojcën C.
- 59** Një aktiv mund të lindë kur një skemë me përfitime të përcaktuara është e mbi-financuar ose në disa raste të caktuara, kur njihen fitime aktuariale. Në raste të tilla, një njësi ekonomike njihet një aktiv sepse:
- (a) njësia ekonomike ka nën kontroll një burim, që është aftësia për ta përdorur suficitin për të krijuar përfitime të ardhshme;
  - (b) ky kontroll është rezultat i ngjarjeve të shkuara (kontributet e paguara nga njësia ekonomike dhe shërbimi i realizuar nga punonjësit); dhe
  - (c) njësia ekonomike ka në dispozicion përfitime ekonomike të ardhshme në formën e një uljeje të kontributeve të ardhshme ose në formën e një kthimi mjetesësh monetare, ose drejtpërdrejt për njësinë ekonomike ose indirekt në drejtim të një skeme tjetër me deficit.
- 60** Kufiri i parashikuar në paragrafin 58(b) nuk e eliminon njohjen e vonuar në kohë të disa humbjeve të caktuara aktuariale (shih paragrafët 92 dhe 93) dhe të disa kostove të caktuara të shërbimit të shkuar (shih paragrafin 96), me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 58A. Megjithatë, ky kufi nuk e shfuqizon opsionin e periudhës kalimtare të parashikuar në paragrafin 155(b). Paragrafi 120A(f)(iii) kërkon që njësia ekonomike të bëjë të ditur çdo shumë që nuk është njohur si aktiv për shkak të kufirit të vendosur në paragrafin 58(b).

---

\* Suficiti është një tepëricë e vlerës së drejtë të aktiveve të skemës mbi vlerën aktuale të detyrimit për përfitime të përcaktuara.

<b>Shembull që ilustron paragrafin 60</b>	
Një skemë me përfitime të përcaktuara ka këto karakteristika:	
Vlera aktuale e detyrimit	1,100
Vlera e drejtë e aktiveve të skemës	(1,190)
	(90)
Humbje aktuariale të panjohura	(110)
Kosto e shërbimi të shkuar	(70)
Rritja e panjohur e pasivit në momentin e përdorimit për herë të parë të Standardit në bazë të paragrafit 155(b)	(50)
Vlera negative e përcaktuar sipas paragrafit 54	(320)
Vlera aktuale e kthimeve të fondeve dhe e uljeve të kontributeve të ardhshme	90
<i>Kufiri i paragrafit 58(b) llogaritet si më poshtë:</i>	
<i>Humbje aktuariale të panjohura</i>	<i>110</i>
<i>Kosto e shërbimit të shkuar</i>	<i>70</i>
<i>Vlera aktuale e kthimeve të fondeve dhe e uljeve të kontributeve të ardhshme</i>	<i>90</i>
<i>Kufiri</i>	<i>270</i>
<i>270 është më e vogël se 320. Për rrjedhojë, njësia ekonomike njeht një aktiv prej 270 dhe bën me dije se ky kufi e ka ulur vlerën kontabël neto të aktivitetit me 50 (shih paragrafin 120A(f)(iii)).</i>	

### **Fitimi ose humbja**

- 61** Një njësi ekonomike njeht shumën gjithsej neto të vlerave të mëposhtme në fitim ose humbje, me përjashtim të rasteve kur ndonjë Standard tjetër kërkon ose lejon përfshirjen e tyre në koston e një aktivi:
- kostoja e shërbimit aktual (shih paragrafët 63-91);
  - kostoja e interesave (shih paragrafin 82);
  - kthimi i pritur mbi aktivet e skemës (shih paragrafët 105-107) dhe mbi të drejtat e rimbursimit (shih paragrafin 104A);
  - fitimet dhe humbjet neto aktuariale, sikurse kërkohen në përputhje me politikën kontabël të njësisë ekonomike (shih paragrafët 92–93D);
  - kostoja e shërbimit të shkuar (shih paragrafin 96);
  - efekti i reduktimeve ose shlyerjeve (shih paragrafët 109 dhe 110); dhe

(g) **efekti i kufirit të paragrafit 58(b), nëse nuk njihet jashtë fitimit ose humbjes në bazë të paragrafit 93C.**

62 Standardet e tjerë kërkojnë përfshirjen e disa kostove të caktuara të përfitimeve të punonjësve në koston e aktiveve siç janë inventarët ose aktivet afatgjata materiale (shih SNK 2 *Inventarët* dhe SNK 16 *Aktivët afatgjata materiale*). Çdo kosto e përfitimeve të pas-punësimit, të përfshira në koston e këtyre aktiveve, përfshin pjesën përkatëse të komponentëve të renditur në paragrafin 61.

## **Njohja dhe matja: vlera aktuale e detyrimeve për përfitime të përcaktuara dhe kostot e shërbimit aktual**

63 Kostoja përfundimtare e një skeme me përfitime të përcaktuara mund të influencohet nga shumë variabla, siç janë pagat përfundimtare, qarkullimi dhe vdekshmëria, prirjet e kostove mjekësore dhe, për një skemë të financiar, fitimet nga investimi i aktiveve të skemës. Kostoja përfundimtare e skemës është e pasigurt dhe kjo pasiguri ka të ngjarë të vijojë për një periudhë të gjatë kohore. Për të matur vlerën aktuale të detyrimeve për përfitimet e pas-punësimit dhe koston përkatëse të shërbimit aktual, është e nevojshme:

- (a) të aplikohet një metodë e vlerësimit aktuarial (shih paragrafët 64-66);
- (b) t'u ngarkohet përfitimi periudhave të shërbimit (shih paragrafët 67-71); dhe
- (c) të ngrihen hipoteza aktuariale (shih paragrafët 72-91).

### **Metoda e vlerësimit aktuarial**

64 **Një njësi ekonomike përdor metodën e kreditimit për njësi të projektuar për të përcaktuar vlerën aktuale të detyrimeve të veta për përfitimet e përcaktuara dhe koston përkatëse të shërbimit aktual dhe, nëse ka, koston e shërbimit të shkuar.**

65 Metoda e vlerësimit aktuarial (ndonjëherë e quajtur si metoda e përfitimeve të njohura përpjesëtimisht me shërbimin ose si metoda e përfitimit në bazë të viteve të shërbimit) konsideron se çdo periudhë shërbimi sjell një njësi shtesë të të drejtës së përfitimit (shih paragrafët 67-71) dhe e mat çdo njësi veças për të arritur deri në detyrimin përfundimtar (shih paragrafët 72-91).

#### **Shembull që ilustron paragrafin 65**

Një përfitim në trajtën e një shume të vetme, i barabartë me 1% të pagës përmbyllëse për çdo vit shërbimi, është i pagueshëm në përfundim të shërbimit. Paga në vitin 1 është 10000 dhe supozohet se rritet me 7% (progresive) çdo vit. Norma e skontimit e përdorur është 10% në vit. Tabela e mëposhtme tregon se si arrihet në detyrimin për një punonjës, i cili pritet të largohet në fund të vitit 5, duke supozuar se nuk ka ndryshime në hipotezat aktuariale. Për thjeshtësi, ky shembull nuk merr parasysh rregullimin shtesë që nevojitet për të pasqyruar probabilitetin se punonjësi mund të largohet nga njësia ekonomike më herët ose më vonë.

Viti	1	2	3	4	5
<i>Përfitimi që u ngarkohet:</i>					
– viteve të mëparshme	0	131	262	393	524
– vitit aktual (1% e pagës përmbyllëse)	131	131	131	131	131
– viteve të mëparshme dhe aktual	131	262	393	524	655

<b>Shembull që ilustron paragrafin 65</b>					
<i>Detyrimi në çelje</i>	–	89	196	324	476
<i>Interesi me 10%</i>	–	9	20	33	48
<i>Kosto e shërbimit aktual</i>	89	98	108	119	131
<i>Detyrimi në mbyllje</i>	89	196	324	476	655
<i>Shënim:</i>					
1.	<i>Detyrimi në çelje është vlera aktuale e përfitimit që i ngarkohet viteve të mëparshme.</i>				
2.	<i>Kostoja e shërbimit aktual është vlera aktuale e përfitimit që i ngarkohet vitit aktual.</i>				
3.	<i>Detyrimi në mbyllje është vlera aktuale e përfitimit që u ngarkohet viteve të mëparshme dhe atij aktual.</i>				

- 66 Njësia ekonomike e skanton të gjithë detyrimin për përfitimet e pas-punësimit, edhe sikur një pjesë e detyrimit të maturohet brenda 12 muajsh pas datës së bilancit.

### **Ngarkimi i përfitimeve periudhave të shërbimit**

- 67 **Gjatë përcaktimit të vlerës aktuale të detyrimeve të veta për përfitimet e përcaktuara dhe kostos përkatëse të shërbimit aktual dhe, nëse ka, kostos së shërbimit të shkuar, njësia ekonomike do ta ngarkojë përfitimin periudhave të shërbimit në bazë të formulës së përfitimeve të skemës. Megjithatë, nëse shërbimi i një punonjësi gjatë viteve të fundit çon në nivele materialisht më të larta përfitimi se shërbimi i viteve më të hershme, njësia ekonomike e ngarkon përfitimin mbi bazë lineare prej:**
- (a) **datës kur shërbimi i punonjësit çon në një përfitim në bazë të skemës (pavarësisht nëse përfitimet janë apo jo të kushtëzuara në shërbimin e ardhshëm); deri në**
  - (b) **datën kur shërbimi i punonjësit çon në një vlerë jo materiale të përfitimeve të mëtejshme në bazë të skemës, e cila nuk vjen nga rritjet e mëtejshme të pagës.**
- 68 Metoda e kreditimit për njësi të projektuar kërkon që një njësi ekonomike t'ia ngarkojë përfitimin periudhës aktuale (me qëllim që të përcaktojë koston e shërbimit aktual) dhe periudhave aktuale e të mëparshme (me qëllim që të përcaktojë vlerën aktuale të detyrimeve për përfitimet e përcaktuara). Një njësi ekonomike e ngarkon përfitimin për periudhat në të cilat lind detyrimi për të dhënë përfitimet e pas-punësimit. Ky detyrim lind kur punonjësit kryejnë shërbimet në këmbim të përfitimeve të pas-punësimit, të cilat pritet që një njësi ekonomike t'i paguajë në periudhat raportuese të ardhshme. Teknikat aktuariale i japin mundësi një njësie ekonomike të matë këtë detyrim me besueshmëri të mjaftueshme për të justifikuar njohjen e një pasivi.

### Shembuj që ilustrojnë paragrafin 68

1. Një skemë me përfitime të përcaktuara jep një përfitim me një shumë të vetme prej 100 në momentin e daljes në pension për çdo vit shërbimi.

*Çdo viti i ngarkohet një përfitim prej 100. Kostoja e shërbimit aktual është vlera aktuale e 100. Vlera aktuale e detyrimit për përfitimeve të përcaktuara është vlera aktuale e 100, e shumëzuar me numrin e viteve të shërbimit deri në datën e bilancit.*

*Nëse përfitimi është i pagueshëm menjëherë kur punonjësi largohet nga njësia ekonomike, kostoja e shërbimit aktual dhe vlera aktuale e detyrimit për përfitime të përcaktuara, pasqyrojnë datën në të cilën pritet të largohet punonjësi. Pra, për shkak të efektit të skontimit, ato janë më pak se shumt që do të përcaktoheshin, po që se punonjësi do të largohej në datën e bilancit.*

2. Një skemë jep një pension mujor prej 0,2% të pagës përmbyllëse për çdo vit shërbimi. Pensioni është i pagueshëm duke filluar nga moshë 65-vjeçare.

*Çdo viti shërbimi i ngarkohet përfitimi i barabartë me vlerën aktuale, në datën e pritur të daljes në pension, të një pensioni mujor sa 0,2% e pagës përmbyllëse të çmuar të pagueshëm duke filluar nga data e pritur e daljes në pension deri në datën e pritur të vdekjes. Kosto e shërbimit aktual është vlera aktuale e këtij përfitimi. Vlera aktuale e detyrimit për përfitime të përcaktuara është vlera aktuale e pagesave mujore të pensionit prej 0,2% të pagës përmbyllëse, e shumëzuar me numrin e viteve të shërbimit deri në datën e bilancit. Kosto e shërbimit aktual dhe vlera aktuale e detyrimit për përfitimet e përcaktuara skontohej sepse pagesat e pensionit fillojnë në moshën 65-vjeçare.*

- 69 Shërbimi i punonjësit çon në lindjen e një detyrimi në bazë të skemës me përfitime të përcaktuara edhe sikur përfitimet të jenë të kushtëzuara me punësimin e ardhshëm (me fjalë të tjera, nuk është fituar ende e drejta për t'i marrë). Shërbimi i punonjësit përpara datës së kushtëzimit çon në lindjen e një detyrimi konstruktiv sepse, në çdo datë bilanci të mëpasshme, zvogëlohet vlera e shërbimit të ardhshëm që do të duhet të kryejë një punonjës përpara se të fitojë të drejtën për përfitimin. Gjatë matjes së detyrimit të saj për përfitimet e përcaktuara, një njësi ekonomike merr në konsideratë probabilitetin që disa punonjës mund të mos i përmbushin kërkesat kushtëzuese. Po kështu, edhe pse disa përfitime të caktuara të pas-punësimit, për shembull, përfitimet mjekësore të pas-punësimit, bëhen të pagueshme vetëm nëse ndodh një ngjarje e specifikuar kur një punonjës i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës, krijohet një detyrim kur një punonjës kryen shërbimin që i jep të drejtën mbi përfitimin nëse ndodh ngjarja e specifikuar. Probabiliteti i ndodhjes së ngjarjes së specifikuar ndikon në matjen e detyrimit, por nuk përcakton nëse ekziston apo jo detyrimi.

### Shembuj që ilustrojnë paragrafin 69

1. Një skemë paguan një përfitim prej 100 për çdo vit shërbimi. E drejta mbi përfitimet fitohet pas dhjetë vjet shërbimi.

*Çdo viti i ngarkohet një përfitim prej 100. Në secilin prej dhjetë vjetëve të parë, kostoja e shërbimit aktual dhe vlera aktuale e detyrimit pasqyrojnë probabilitetin se punonjësi mund të mos i përfundojë dhjetë vjet shërbim.*

2. Një skemë paguan një përfitim prej 100 për çdo vit shërbimi, duke përjashtuar shërbimin përpara moshës 25-vjeçare. E drejta mbi përfitimet fitohet menjëherë.

*Asnjë përfitim nuk i ngarkohet shërbimit përpara moshës 25-vjeçare sepse shërbimi i kryer përpara kësaj date nuk çon në përfitime (të kushtëzuara apo të pakushtëzuara). Çdo viti të mëpasshëm i ngarkohet një përfitim prej 100.*

- 70 Detyrimi rritet deri në datën kur shërbimi i mëtejshëm i punonjësit çon në një vlerë jo materiale të përfitimeve të mëtejshme. Për rrjedhojë, i gjithë përfitimi u ngarkohet periudhave që mbyllen në këtë datë ose përpara kësaj date. Përfitimi u ngarkohet periudhave të veçanta kontabël në bazë të formulës së përfitimeve të skemës. Megjithatë, nëse shërbimi i një punonjësi gjatë viteve të fundit çon në nivele materialisht më të larta përfitimi se shërbimi i viteve më të hershme, njësia ekonomike e ngarkon përfitimin në formë lineare deri në datën kur shërbimi i mëtejshëm i punonjësit nuk çon më në vlera materiale të përfitimeve të ardhshme. Kjo sepse shërbimi i punonjësit gjatë gjithë periudhës do të çojë përfundimisht në një përfitim në këtë nivel më të lartë.



## Shembuj që ilustrojnë paragrafin 70

1. Një skemë paguan një përfitim me një shumë të vetme prej 1000 që kushtëzohet pas dhjetë vjet shërbimi. Skema nuk ofron asnjë përfitim tjetër për shërbimin e mëvonshëm.

*Secilit prej dhjetë vjetëve të parë i ngarkohet një përfitim prej 100 (1000 pjesëtuar me 10). Në secilin prej dhjetë vjetëve të parë, kostoja e shërbimit aktual pasqyron probabilitetin se punonjësi mund të mos i përfundojë dhjetë vjet shërbim. Viteve të mëpasshme nuk u ngarkohet asnjë përfitim.*
2. Një skemë u paguan një përfitim pensioni në një shumë të vetme prej 2000 të gjithë punonjësve të cilët janë ende në marrëdhënie pune në moshën 55-vjeçare pas 20 vjet shërbimi, ose të cilët janë ende në marrëdhënie pune në moshën 65-vjeçare, pa marrë në konsideratë kohëzgjatjen e shërbimit.

*Për ata punonjës të cilët fillojnë punë përpara moshës 35-vjeçare, shërbimi çon në fillim, në përfitime në bazë të skemës në moshën 35-vjeçare (një punonjës mund të largohet në moshën 30-vjeçare dhe të kthehet në moshën 33-vjeçare, pa pasur asnjë efekt në vlerën ose kohën e përfitimeve). Këto përfitime kushtëzohen me shërbim të mëtejshëm. Po kështu, shërbimi pas moshës 55-vjeçare nuk çon në ndonjë vlerë materiale të përfitimeve të mëtejshme. Për këta punonjës, njësia ekonomike ngarkon një përfitim prej 100 (2000 pjesëtuar me 20) për secilin vit nga moshë 35-vjeçare deri në moshën 55-vjeçare.*

*Për punonjësit të cilët fillojnë punë midis moshës 35-vjeçare dhe 45-vjeçare, shërbimi pas njëzetë vjetësh shërbim nuk çon në ndonjë vlerë materiale të përfitimeve të mëtejshme. Për këta punonjës, njësia ekonomike ngarkon një përfitim prej 100 (2000 pjesëtuar me 20) për secilin prej njëzetë viteve të para.*

*Për punonjësit të cilët fillojnë punë pas moshës 55-vjeçare, shërbimi pas dhjetë vjetësh shërbim nuk çon në ndonjë vlerë materiale të përfitimeve të mëtejshme. Për këta punonjës, njësia ekonomike ngarkon një përfitim prej 200 (2000 pjesëtuar me 10) për secilin prej dhjetë viteve të para.*

*Për të gjithë punonjësit, kostoja e shërbimit aktual dhe vlera aktuale e detyrimit pasqyrojnë probabilitetin se punonjësi mund të mos e përfundojë periudhën e nevojshme të shërbimit.*
3. Një skemë mjekësore pas-punësimi rimbursor 40% të kostove mjekësore të një punonjësi pas ndërprerjes së marrëdhënies të punës, nëse ky punonjës i ndërpret marrëdhëniet e punës pas më shumë se dhjetë vjetësh dhe më pak se njëzetë vjetësh shërbimi dhe 50% të këtyre kostove nëse punonjësi i ndërpret marrëdhëniet e punës pas njëzetë ose më shumë vjetësh shërbimi.

*Në bazë të formulës së përfitimeve të skemës, njësia ekonomike i ngarkon 4% të vlerës aktuale të kostove mjekësore të pritura (40% pjesëtuar me dhjetë) secilit prej dhjetë vjetëve të parë dhe 1% (10% pjesëtuar me dhjetë) secilit prej dhjetë vjetëve të dytë. Kostoja e shërbimit aktual në secilin vit pasqyron probabilitetin se punonjësi mund të mos e përfundojë periudhën e nevojshme të shërbimit për të fituar një pjesë apo të gjithë përfitimet. Për punonjësit që priten të largohen brenda dhjetë vjetësh, nuk ngarkohet asnjë përfitim.*
4. Një skemë mjekësore pas-punësimi rimbursor 10% të kostove mjekësore të një punonjësi pas ndërprerjes së marrëdhënies të punës nëse ky punonjës i ndërpret marrëdhëniet e punës pas më shumë se dhjetë vjetësh dhe më pak se njëzetë vjetësh shërbimi dhe 50% të këtyre kostove nëse punonjësi i ndërpret marrëdhëniet e punës pas njëzetë ose më shumë vjetësh shërbimi.

*Shërbimi i një punonjësi gjatë viteve të fundit nuk çon në nivele materialisht më të larta përfitimi se shërbimi i viteve më të hershme. Për rrjedhojë, për punonjësit që priten të largohen pas njëzetë apo më shumë vjetësh, njësia ekonomike e ngarkon përfitimin në mënyrë lineare sipas paragrafit 68. Shërbimi pas njëzetë vjetësh nuk çon në ndonjë vlerë me rëndësi materiale të përfitimeve të mëtejshme. Për rrjedhojë, përfitimi që i ngarkohet secilit prej njëzetë vjetëve të parë është 2,5% e vlerës aktuale të kostove mjekësore të pritura (50% pjesëtuar me njëzetë).*

*Për punonjësit që priten të largohen midis dhjetë dhe njëzetë vjetësh, përfitimi që i ngarkohet secilit prej dhjetë vjetëve të parë është 1% e vlerës aktuale të kostove mjekësore të pritura. Për punonjësit që priten të largohen midis dhjetë dhe njëzetë vjetësh, përfitimi që i ngarkohet secilit prej dhjetë vjetëve të parë është 1% e vlerës aktuale të kostove mjekësore të pritura.*

*Për punonjësit që priten të largohen brenda dhjetë vjetësh, nuk ngarkohet asnjë përfitim.*

- (a) për qëllime të paragrafit 67(b), rritjet e pagës nuk çojnë në përfitime të mëtejshme, edhe pse vlera e përfitimeve varet nga paga përmbyllëse; dhe
- (b) vlera e përfitimit që i ngarkohet çdo periudhe është një përqindje konstante e pagës me të cilët lidhet përfitimi.

#### **Shembull që ilustron paragrafin 71**

Punonjësit kanë të drejtë të marrin një përfitim prej 3% të pagës përmbyllëse për çdo vit shërbimi përpara moshës 55-vjeçare.

*Përfitimi prej 3% e pagës përmbyllëse të vlerësuar i ngarkohet çdo viti deri në moshën 55-vjeçare. Kjo është data pas së cilës shërbimi i mëtejshëm i punonjësit nuk çon në ndonjë vlerë materiale të përfitimeve të mëtejshme në bazë të skemës. Pas kësaj moshë, shërbimit nuk i ngarkohet asnjë përfitim.*

### **Hipotezat aktuariale**

#### **72 Hipotezat aktuariale duhet të jenë të paparagjykuara dhe reciprokisht të përputhshme.**

73 Hipotezat aktuariale janë çmuarjet më të mira të një njësie ekonomike në lidhje me variablat, të cilat do të përcaktojnë koston e ofrimit të përfitimeve të pas-punësimit. Hipotezat aktuariale përbëhen nga:

- (a) supozimet demografike për karakteristikat e ardhshme të punonjësve ekzistues dhe të ardhshëm (dhe personat në varësi të tyre) të cilët kanë të drejtë t'i marrin përfitimet. Supozimet demografike trajtojnë çështje të tilla si:
  - (i) vdekshmëria, si gjatë marrëdhënive të punës ashtu edhe pas ndërprerjes së tyre;
  - (ii) normat e qarkullimit të punonjësve, të paafëtisë në punë dhe të daljes në pension përpara moshës;
  - (iii) përqindja e pjesëtarëve të skemës që kanë persona në varësi, të cilët do të fitojnë të drejtën për të marrë përfitimet; dhe
  - (iv) përqindja e kërkesave për pagesë në bazë të skemave mjekësore; dhe
- (b) supozimet financiare, që trajtojnë zëra të tilla si:
  - (i) norma e skontimit (shih paragrafët 78-82);
  - (ii) nivelet e ardhshme të pagave dhe përfitimeve (shih paragrafët 83-87);
  - (iii) në rastin e përfitimeve mjekësore, kostot mjekësore të ardhshme, përfshirë, në ato raste kur ka rëndësi materiale, koston e administrimit të kërkesave për rimbursim dhe të pagesave të përfitimeve (shih paragrafët 88-91); dhe
  - (iv) normën e prituri të kthimit mbi aktivet e skemës (shih paragrafët 105-107).

74 Hipotezat aktuariale janë të paparagjykuara nëse nuk janë as të pakujdesshme e as tejet konservative.

75 Hipotezat aktuariale janë të përputhshme reciprokisht nëse pasqyrojnë marrëdhëniet ekonomike midis faktorëve të tillë siç janë inflacioni, nivelet e rritjes së pagave, kthimi mbi aktivet e skemës dhe normat e skontimit. Për shembull, të gjitha hipotezat të cilat mbështeten në një nivel të caktuar inflacioni (siç janë hipotezat për normat e interesit dhe rritjet e pagave dhe të përfitimeve) në çdo periudhë të ardhshme marrin si të qenë të njëjtin nivel inflacioni në këtë periudhë.

76 Një njësi ekonomike e përcakton normën e skontimit dhe supozimet e tjera financiare në terma nominalë (të shprehur), përveç rasteve kur çmuarjet në terma realë (të rregulluara me inflacionin) janë më të besueshme, për shembull, në një ekonomi hiperinflacioniste (shih SNK 29 *Raportimi financiar në ekonomitë hiperinflacioniste*), ose kur përfitimi është lidhur me një indeks dhe ka një treg të thellë të obligacioneve të lidhura me një indeks në të njëjtën monedhë dhe të njëjtat kushte.

77 **Hipotezat financiare duhet të mbështeten në pritshmërinë e tregut, në datën e bilancit, për periudhën gjatë së cilës duhet të shlyhen detyrimet.**

### **Hipotezat aktuariale: norma e skontimit**

78 **Norma e përdorur për të skontuar detyrimet për përfitimet e pas-punësimit (të financuara dhe të pafinancuara) përcaktohet duke u mbështetur në normat e kthimit të tregut mbi obligacionet tregtare të**

**cilësisë së lartë në datën e bilancit. Në vendet ku nuk ka treg të thellë për këto obligacione, përdoren normat e kthimit të tregut (në datën e bilancit) mbi obligacionet qeveritare. Monedha dhe maturimi i obligacioneve tregtare ose shtetërore duhet të përputhen me monedhën dhe maturimin e vlerësuar të detyrimeve për përfitimet e pas-punësimit.**

- 79 Një hipotezë aktuariale e cila ka një efekt material është norma e skontimit. Norma e skontimit pasqyron vlerën në kohë të pasasë por jo rrezikun aktuarial apo atë të investimit. Për më tepër, norma e skontimit nuk pasqyron rrezikun specifik të kredisë për njësinë ekonomike të cilin e mbajnë kreditorët e njësisë ekonomike, dhe as rrezikun që përvoja e ardhshme mund të ndryshojë nga hipotezat aktuariale.
- 80 Norma e skontimit pasqyron afatin e vlerësuar të pagesave të përfitimeve. Në praktikë, një njësi ekonomike shpesh e arrin një gjë të tillë duke aplikuar një normë skontimi mesatare të ponderuar e cila pasqyron kohën dhe shumën e vlerësuar të pagesave të përfitimeve dhe monedhën në të cilët duhet të paguhet përfitimet.
- 81 Në disa raste, mund të mos ketë një treg të thellë për obligacione me maturim mjaftueshmërisht të gjatë për t'ia përshtatur maturimit të të gjitha pagesave të përfitimeve. Në raste të tilla, një njësi ekonomike përdor normat aktuale të tregut me kohëzgjatje të përshtatshme për të skontuar pagesat më afatshkurtra dhe bën një çmuarje të normës së skontimit për maturimet më të gjata duke përdorur ekstrapolim të normave aktuale të tregut përgjatë kurbës së normave të kthimit. Vlera aktuale gjithsej e detyrimit për përfitime të përcaktuara nuk ka të ngjarë të jetë veçanërisht e ndryshme ndaj normës së skontimit të aplikuar për atë pjesë të përfitimeve, që janë të pagueshme përtej maturimit përfundimtar të obligacioneve tregtare ose qeveritare.
- 82 Kostoja e interesit llogaritet duke shumëzuar normën e skontimit të përcaktuar në fillim të periudhës me vlerën aktuale të detyrimit për përfitimet e përcaktuara përgjatë gjithë periudhës, duke marrë në konsideratë të gjitha ndryshimet metariale të detyrimit. Vlera aktuale e detyrimit ndryshon nga pasivi i njohur në bilanc, sepse pasivi njihet pasi zbritet vlera e drejtë e aktiveve të skemës dhe sepse, disa fitime dhe humbje neto aktuariale si edhe disa kosto të shërbimit të shkuar nuk njihen menjëherë. [Shtojcë A ilustron, mes të tjerash, edhe llogaritjen e kostonë së interesit.]

## **Hipotezat aktuariale: pagat, përfitimet e tjera dhe kostot shëndetësore**

- 83 **Detyrimet për përfitimet e pas-punësimit maten mbi një bazë e cila pasqyron:**
- (a) rritjet e vlerësuar të pagave në të ardhmen;
  - (b) përfitimet e parashikuara në kushtet e skemës (ose që lindin nga detyrimi konstruktiv i cili shkon përtej këtyre kushteve) në datën e bilancit; dhe
  - (c) ndryshimet e vlerësuar të ardhshme të nivelit të përfitimeve shtetërore, të cilat do të kenë ndikim në përfitimet e pagueshme në bazë të skemës me përfitime të përcaktuara, atëherë dhe vetëm atëherë, kur:
    - (i) këto ndryshime hyjnë në fuqi përpara datës së bilancit; ose
    - (ii) historia e shkuar ose informacione të tjera të besueshme, tregojnë se këto përfitime shtetërore do të ndryshojnë në një mënyrë të parashikueshme për shembull, në përputhje me ndryshimet e ardhshme të niveleve të përgjithshme të çmimeve ose të niveleve të përgjithshme të pagave.
- 84 Çmuarjet e rritjeve të ardhshme të pagave marrin në konsideratë inflacionin, vjetërsinë në punë, ngritjen në detyrë dhe faktorët të tjerë përkatës, siç janë kërkesa dhe oferta në tregun e punës.
- 85 Nëse kushtet formale të skemës (ose detyrimi konstruktiv, i cili shkon përtej këtyre kushteve) i kërkojnë njësisë ekonomike t'i ndryshojë përfitimet në periudhat e ardhshme, matja e detyrimit pasqyron edhe këto ndryshime. Për shembull, kështu ndodh kur:
- (a) njësia ekonomike ka një histori të rritjes së përfitimeve për shembull, për të zbutur efektet e inflacionit dhe nuk ka indikacion se kjo praktikë do të ndryshojë në të ardhmen; ose
  - (b) fitimet neto aktuariale janë njohur më parë në pasqyrat financiare dhe njësia ekonomike ka detyrimin, ose përmes kushteve formale të skemës (ose përmes një detyrimi konstruktiv, i cili shkon përtej këtyre kushteve) ose nga legjislacioni, për ta përdorur suficitin e skemës në të mirë të pjesëmarrësve të skemës) shih paragrafin 98(c).
- 86 Hipotezat aktuariale nuk i pasqyrojnë ndryshimet e ardhshme të përfitimeve, të cilat nuk parashikohen në kushtet formale të skemës (ose nga një detyrim konstruktiv) në datën e bilancit. Ndryshime të tilla çojnë në:
- (a) kosto të shërbimit të shkuar, për aq sa ato i ndryshojnë përfitimet për shërbimin deri në momentin e ndryshimit; dhe
  - (b) kosto të shërbimit aktual për periudhat pas momentit të ndryshimit, për aq sa ato i ndryshojnë përfitimet për shërbimin pas momentit të ndryshimit.

- 87 Disa përfitime të pas-punësimit lidhen me variabla të tilla si niveli i përfitimeve të pensioneve shtetërore ose kujdesi shëndetësor shtetëror. Matja e përfitimeve të tilla pasqyron ndryshimet e pritura të këtyre variablove, në bazë të historisë së shkuar dhe të informacioneve të tjera besueshme.
- 88 **Supozimet për kostot mjekësore marrin në konsideratë ndryshimet e vlerësuara të ardhshme të kostos së shërbimeve mjekësore, që lindin si nga inflacioni ashtu edhe nga ndryshimet specifike të kostove mjekësore.**
- 89 Matja e përfitimeve mjekësore të pas-punësimit kërkon supozime për nivelet dhe shpeshtësinë e kërkesave të ardhshme për rimbursim dhe të kostos së kërkuar për të plotësuar këto kërkesa. Njësia ekonomike i çmon kostot e ardhshme mjekësore në bazë të të dhënave historike për përvojën e vetë njësisë ekonomike të plotësuar, nëse ka nevojë, me të dhëna historike të njësisë ekonomike të tjera, shoqërive të sigurimeve, ofruesve të shërbimeve mjekësore ose të burimeve të tjera. Çmuarjet e kostove mjekësore të ardhshme marrin në konsideratë efektin e përparimit teknologjik, ndryshimet në përdorimin e kujdesit shëndetësor os në modelet e dhënies së tij, dhe ndryshimet në gjendjen shëndetësore të pjesëmarrësve të skemës.
- 90 Niveli dhe shpeshtësia e kërkesave për rimbursim janë veçanërisht të ndjeshme ndaj moshës, gjendjes shëndetësore dhe gjinisë së punonjësve (dhe personave në varësi të tyre) dhe mund të jenë të ndjeshme edhe ndaj faktorëve të tjerë siç është vendndodhja gjeografike. Për rrjedhojë, të dhënat historike të rregullohen për aq sa kjo përzjerje demografike e popullsisë ndryshon nga ajo e popullsisë të përdorur si bazë për të dhënat historike. Ato rregullohen edhe atëherë kur ka informacion të besueshëm se nuk do të vazhdojnë prirjet historike.
- 91 Disa skema të kujdesit shëndetësor të pas-punësimit kërkojnë që punonjësit të japin kontributin e tyre për kostot mjekësore të mbuluara nga skema. Çmuarjet e kostove mjekësore të ardhshme mbajnë parasysh këto kontribute, në bazë të kushteve të skemës në datën e bilancit (ose në bazë të detyrimit konstruktiv, i cili shkon përtej këtyre kushteve). Ndryshimet e këtyre kontributeve të punonjësve çojnë në kosto të shërbimit të shkuar ose kur ka, në reduktime. Kostoja e plotësimit të kërkesave mund të ulet me përfitimet e marra nga shteti ose nga ofruesit e tjerë të shërbimeve mjekësore (shih paragrafët 83(c) dhe 87).

### **Fitimet dhe humbjet neto aktuariale**

- 92 **Gjatë matjes së pasivit për përfitimeve të përcaktuara në përputhje me paragrafin 54, në pajtim me paragrafin 58A, njësia ekonomike njih një pjesë (sikurse specifikohet në paragrafin 93) të fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale si të ardhura ose shpenzime nëse fitimet dhe humbjet neto aktuariale progresive të panjohura në fund të periudhës paraardhëse të raportimit, do të ishin më të mëdha se vlera më e madhe midis:**
- (a) 10% e vlerës aktuale të detyrimit për përfitime të përcaktuara në atë datë (përpara se të zbriten aktivet e skemës); dhe
  - (b) 10% e vlerës së drejtë të aktiveve të skemës në atë datë.

**Këta kufij llogariten dhe aplikohen veças për çdo skemë me përfitime të përcaktuara.**

- 93 **Përqindja e fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale që duhet njohur për çdo skemë me përfitime të përcaktuara është teprica që përcaktohet në bazë të paragrafit 92, e pjesëtuar me jetët mesatare të pritura të punës të mbetura të punonjësve që marrin pjesë në skemë. Megjithatë, një njësi ekonomike mund të përdorë çdo metodë sistematike, që sjell një njohje më të shpejtë të fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale, me kusht që të zbatohet e njëjta bazë si për fitimet ashtu edhe për humbjet dhe që baza të aplikohet në mënyrë të njëjtë nga njëra periudhë në tjetrën. Një njësi ekonomike mund t'i aplikojë metoda të tilla sistematike për fitimet dhe humbjet neto aktuariale edhe nëse ato bien midis kufijve të specifikuar në paragrafin 92.**
- 93A **Nëse, sikurse e lejon paragrafi 93, një njësi ekonomike ndjek një politikë të njohjes së fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale në periudhën në të cilën ato ndodhin, ajo mund t'i njohë ato jashtë fitimit ose humbjes, në përputhje me paragrafët 93B–93D, me kusht që këtë ta bëjë për:**
- (a) të gjitha skemat me përfitime të përcaktuara; dhe
  - (b) të gjitha fitimet dhe humbjet neto aktuariale.
- 93B Fitimet dhe humbjet neto aktuariale, të njohura jashtë fitimit ose humbjes, sikurse e lejon paragrafi 93A, paraqiten në një pasqyrë të ndryshimeve në kapitalin neto me titull “Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura”, që përbëhet vetëm nga zërat e specifikuar në paragrafin 96 të SNK 1 (të ndryshuar në 2003). Njësia ekonomike nuk i paraqet fitimet dhe humbjet neto aktuariale në një pasqyrë të ndryshimeve në kapitalin neto sipas formatit me kolona të parashikuar në paragrafin 101 të SNK 1 dhe në asnjë format tjetër i cili përfshin zërat e specifikuar në paragrafin 97 të SNK 1.
- 93C Një njësi ekonomike e cila i njih fitimet dhe humbjet neto aktuariale në përputhje me paragrafin 93A njih edhe çdo rregullim, që lind nga kufiri i vendosur në paragrafin 58(b), jashtë fitimit ose humbjes në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura.

- 93D Fitimet dhe humbjet neto aktuariale dhe rregullimet që lindin nga kufiri i vendosur në paragrafin 58(b), të cilat janë njohur jashtë fitimit ose humbjes në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, njihen menjëherë në fitimin e pashpërndarë. Ato nuk njihen në fitimin ose humbjen në një periudhë të mëpasshme.
- 94 Fitimet dhe humbjet neto aktuariale mund të lindin nga rritjet ose uljet e vlerës aktuale të një detyrimi të përfitimeve të përcaktuara ose të vlerës së drejtë të çdo aktivi të lidhur të skemës. Shkaqet e fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale përfshijnë, për shembull:
- (a) norma të larta ose të ulëta, që nuk priten, të qarkullimit të punonjësve, të daljes së parakohshme në pension ose të vdekshmërisë së punonjësve ose të rritjeve të pagave, përfitimeve (nëse kushtet formale apo konstruktive të një skeme parashikojnë rritje të përfitimeve për shkak të inflacionit) ose të kostove mjekësore;
  - (b) efekti i ndryshimeve të çmuarjeve të qarkullimit të punonjësve, të daljes herët në pension, ose të vdekshmërisë së punonjësve apo të rritjes së pagave, përfitimeve (nëse kushtet formale apo konstruktive të një skeme parashikojnë rritje të përfitimeve për shkak të inflacionit) ose të kostove mjekësore, për të ardhmen;
  - (c) efekti i ndryshimit të normës së skontimit; dhe
  - (d) diferencat midis kthimit faktik nga aktivet e skemës dhe kthimit të pritur mbi aktivet e skemës (shih paragrafët 105-107).
- 95 Në periudhën afatgjatë, fitimet dhe humbjet neto aktuariale mund të kompensojnë njëra tjetrën. Për rrjedhojë, çmuarjet e detyrimeve për përfitime të përcaktuara mund të shikohen si një diapazon (ose “korridor”) rreth çmuarjes më të mirë. I lejohet, por nuk i kërkohet, njësisë ekonomike t’i njohë fitimet dhe humbjet neto aktuariale të cilat bien brenda këtij diapazoni. Ky Standard i kërkon njësisë ekonomike të njohë, si minimum, një pjesë të specifikuar të fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale të cilat bien jashtë një “korridori” me plus ose minus 10%. [Shtojcë A ilustron, mes të tjerash, edhe llogaritjen e fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale.] Ky Standard lejon edhe përdorimin e metodave sistematike të njohjes më të shpejtë, me kusht që këto metoda të plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin 93. Për shembull, në këto metoda të lejuara përfshihet njohja e menjëhershme e të gjitha fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale që bien si brenda ashtu edhe jashtë “korridorit”. Paragrafi 155(b)(iii) shpjegon nevojën për të marrë në konsideratë çdo pjesë të panjohur të pasivit kalimtar gjatë kontabilizimit të fitimeve neto aktuariale të mëpasshme.

### Kosto shërbimi e të kaluarës

- 96 Gjatë matjes së pasivit për përfitime të përcaktuara në bazë të paragrafit 54, njësia ekonomike, në varësi të paragrafit 58A, e njeh koston e shërbimit të shkuar si shpenzim mbi një bazë lineare gjatë periudhës mesatare deri sa të jetë fituar e drejta për t’i marrë përfitimet. Për aq sa është fituar e drejta për t’i marrë përfitimet menjëherë pas futjes apo ndryshimit të një skeme me përfitime të përcaktuara, njësia ekonomike e njeh menjëherë koston e shërbimit të shkuar.
- 97 Kostoja e shërbimit të shkuar lind kur njësia ekonomike fut një skemë me përfitime të përcaktuara ose i ndryshon përfitimet e pagueshme të një skeme ekzistuese me përfitime të përcaktuara. Ndryshime të tilla bëhen në këmbim të shërbimit të punonjësve gjatë periudhës deri sa të jetë fituar e drejta për t’i marrë përfitimet në fjalë. Për rrjedhojë, kostoja e shërbimit të shkuar njihet gjatë kësaj periudhe, pavarësisht nëse kjo kosto ka të bëjë me shërbimin e punonjësve në periudhat e mëparshme. Kostoja e shërbimit të shkuar matet si ndryshim i pasivit që lind nga amendimi (shih paragrafin 64).

<b>Shembull që ilustron paragrafin 97</b>	
Një njësi ekonomike administron një skemë pensionesh e cila jep një pension mujor prej 2% të pagës përmbyllëse për çdo vit shërbimi. E drejta mbi përfitimet fitohet pas pesë vjet shërbimi. Më 1 janar 20X5, njësia ekonomike e përmirëson pensionin me 2,5% të pagës përmbyllëse për çdo vit shërbimi, duke filluar nga data 1 janar 20X1. Më datën e përmirësimit të pensionit, vlera aktuale e përfitimeve shtesë për shërbimin nga data 1 janar 20X1 deri më 1 janar 20X5 është si më poshtë:	
Punonjës me më shumë se pesë vjet shërbim më 1/1/X5	150
Punonjës me më pak se pesë vjet shërbim më 1/1/X5 (periudha mesatare deri në fitimin e së drejtës për të marrë përfitimet: tre vjet)	120
	270

## Shembull që ilustron paragrafin 97

*Njësia ekonomike njeh menjëherë 150, sepse është fituar e drejta për t'i marrë këto përfitime. Njësia ekonomike njeh 120 me bazë lineare gjatë tre vjetëve nga data 1 janar 20X5.*

- 98 Kostoja e shërbimit të shkuar përjashton:
- (a) efektin e diferencave midis rritjeve faktike dhe rritjeve të supozuara të pagave dhe detyrimit për të paguar përfitime për shërbimin e kryer në vitet e mëparshme (nuk ka kosto të shërbimit të shkuar sepse hipotezat aktuariale mundësojnë parashikimin e pagave);
  - (b) nënvlerësimet dhe mbivlerësimet e rritjeve të lira të pensioneve, kur një njësi ekonomike ka detyrimin konstruktiv për të bërë rritje të tilla (nuk ka kosto të shërbimit të shkuar sepse hipotezat aktuariale i lejojnë rritje të tilla);
  - (c) çmuarjet e rritjes së përfitimeve, të cilat janë rezultat i fitimeve neto aktuariale që janë njohur në pasqyrat financiare kur njësia ekonomike është e detyruar, ose përmes kushteve formale të një skeme (ose përmes një detyrimi konstruktiv që shkon përtej këtyre kushteve) apo nga legjislacioni, që të përdorë suficitin e skemës në formë përfitimi për pjesëmarrësit e skemës, edhe sikur rritja e përfitimeve të mos jetë dhënë ende formalisht (rritja përkatëse e detyrimit është një humbje neto aktuariale dhe jo një kosto e shërbimit të shkuar, shih paragrafin 85(b));
  - (d) rritjen e përfitimeve për të cilat është fituar e drejta kur, në mungesë të përfitimeve të reja ose të përmirësuara, punonjësit i përmbushin kërkesat e fitimit të së drejtës për t'i marrë përfitimet (nuk ka kosto të shërbimit të shkuar sepse kostoja e vlerësuar e përfitimeve është njohur më parë si kosto e shërbimit aktual në momentin kur është kryer shërbimi); dhe
  - (e) efektin e ndryshimit të skemës, i cili i pakëson përfitimet për shërbimin e ardhshëm (ky është rasti i një reduktimi).
- 99 Njësia ekonomike përpilon tabelën e amortizimit për koston e shërbimit të shkuar kur futen ose ndryshohen përfitimet. Do të ishte e pazbatueshme të mbaheshin të dhënat e hollësishme të nevojshme për të identifikuar dhe zbatuar ndryshimet e mëpasshme të kësaj tabele amortizimi. Për më tepër, ka të ngjarë që efekti të jetë material vetëm nëse ka një reduktim ose shlyerje të skemës. Për rrjedhojë, njësia ekonomike e ndryshon tabelën e amortizimit për koston e shërbimit të shkuar vetëm nëse ka një reduktim apo shlyerje të skemës.
- 100 Kur njësia ekonomike i redukton përfitimet e pagueshme në kuadër të një skeme ekzistuese me përfitime të përcaktuara, ulja përkatëse e pasivit për përfitime të përcaktuara njihet si kosto (negative) e shërbimit të shkuar gjatë periudhës mesatare deri sa të jetë fituar e drejta për të marrë pjesën e reduktuar të përfitimeve.
- 101 Kur njësia ekonomike i redukton disa përfitime të caktuara të pagueshme në kuadër të një skeme ekzistuese me përfitime të përcaktuara dhe, në të njëjtën kohë, rrit përfitime të tjera të pagueshme në kuadër të skemës për të njëjtët punonjës, njësia ekonomike e trajton këtë ndryshim si një ndryshim të vetëm neto.

## Njohja dhe matja: aktivet e skemës

### Vlera e drejtë e aktiveve të skemës

- 102 Vlera e drejtë e aktiveve të skemës zbritet kur përcaktohet shuma që njihet në bilanc në bazë të paragrafit 54. Kur nuk ka çmim tregu, bëhet një çmuarje e vlerës së drejtë të aktiveve të skemës. Për shembull, përmes skontimit të flukseve monetare të ardhshme të pritura duke përdorur një normë skontimi e cila pasqyron si rrezikun përkatës së aktiveve të skemës, ashtu edhe maturimin ose datën e pritur të heqjes nga pronësia të këtyre aktiveve (ose, nëse nuk kanë maturim, periudhën e pritur deri në momentin e shlyerjes së detyrimit të lidhur).
- 103 Aktivitet e skemës nuk përfshijnë kontributet e papaguara, të cilat i detyrohet fondit njësia raportuese dhe as instrumentet financiare të patransferueshme, të emetuara nga njësia ekonomike dhe të mbajtura për shitje nga fondi. Aktivete të skemës u zbriten ato pasive të fondit, të cilat nuk kanë lidhje me përfitimet e punonjësve, siç janë për shembull, pasivet tregtare dhe llogari të tjera të pagueshme dhe pasivet që lindin nga instrumentet financiarë derivativë.
- 104 Kur në aktivet e skemës janë përfshirë policat sigurimesh kualifikuese, të cilat përputhen në mënyrë ekzakte me vlerën dhe kohën e disa përfitimeve ose të gjitha përfitimeve të pagueshme në kuadër të skemës, vlera e drejtë e këtyre policave konsiderohet se është vlera aktuale e detyrimeve të lidhura, sikurse përshkruhet në paragrafin 54 (në varësi të reduktimit të kërkuar nëse nuk janë rikuperuar tërësisht shumat e arkëtueshme në kuadër të policave të sigurimit).

## Rimbursimet

- 104A** Njësia ekonomike e njeh të drejtën e vet për rimbursim si aktiv më vete atëherë dhe vetëm atëherë kur është thuajse e sigurt se një pjesë ose të gjithë shpenzimin që kërkohet për të shlyer një detyrim për përfitime të përcaktuara do ta rimbursojë një palë tjetër. Njësia ekonomike e mat aktivin me vlerën e drejtë. Në të gjitha aspektet e tjera, njësia ekonomike e trajton këtë aktiv njëloj si aktivet e skemës. Në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, shpenzimi që ka të bëjë me një skemë me përfitime të përcaktuara mund të paraqitet në formë neto pasi i është zbritur shuma e njohur për rimbursimin.
- 104B** Ndonjëherë, një njësi ekonomike mund t'i drejtohet një pale tjetër, për shembull një shoqërie sigurimesh, për të paguar një pjesë ose të gjithë shpenzimin që kërkohet për të shlyer një detyrim për përfitime të përcaktuara. Policat kualifikuese të sigurimeve, sikurse përcaktohet në paragrafin 7, janë aktive të skemës. Njësia ekonomike i kontabilizon policat kualifikuese të sigurimeve njësoj si të gjitha aktivet e tjera të skemës, dhe nuk aplikon paragrafin 104A (shih paragrafët 39-42 dhe 104).
- 104C** Kur një policë sigurimi nuk është kualifikuese, atëherë kjo policë nuk është aktiv i skemës. Këto raste i trajton paragrafi 104A: njësia ekonomike njeh të drejtën për rimbursim në bazë të policës së sigurimit si aktiv më vete, dhe jo si zbritje gjatë përcaktimit të pasivit për përfitime të përcaktuara të njohur në bazë të paragrafit 54; në të gjitha aspektet e tjera, njësia ekonomike e trajton këtë aktiv njësoj si aktivet e skemës. Në veçanti, pasivi për përfitime të përcaktuara, i njohur në bazë të paragrafit 54 rritet (zvogëlohet) për aq sa mbeten të panjohura fitimet (humbjet) neto aktuariale progresive mbi detyrimin për përfitime të përcaktuara dhe mbi të drejtën e lidhur për rimbursim në bazë të paragrafëve 92 dhe 93. Paragrafi 120A(f)(iv) i kërkon njësisë ekonomike të japë një përshkrim të shkurtër të lidhjes midis të drejtës për rimbursim dhe detyrimit të lidhur me të.

<b>Shembull që ilustron paragrafët 104A–104C</b>	
Vlera aktuale e detyrimit	1,241
Fitimet aktuariale të panjohura	17
Pasivi i njohur në bilanc	1,258
Të drejtat sipas policave të sigurimeve, të cilat përputhen në mënyrë ekzakte me vlerën dhe kohën e disa përfitimeve të pagueshme në bazë të skemës. Këto përfitime kanë një vlerë aktuale prej 1,092.	1,092
Fitimeve aktuariale neto të panjohura prej 17 u janë zbritur fitimet aktuariale progresive mbi detyrimin dhe mbi të drejtat për rimbursim.	

- 104D Nëse e drejta për rimbursim lind në bazë të një police sigurimi, e cila përputhet në mënyrë ekzakte me vlerën dhe kohën e disa përfitimeve ose të gjitha përfitimeve të pagueshme në kuadër të skemës, vlera e drejtë e kësaj të drejte për rimbursim konsiderohet se është vlera aktuale e detyrimit të lidhur, sikurse përshkruhet në paragrafin 54 (në varësi të reduktimit të kërkuar nëse rimbursimi nuk është rikuperuar tërësisht).

#### **Kthimi mbi aktivet e skemës**

- 105 Kthimi i pritur mbi aktivet e skemës është një përbërës i shpenzimit të njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Diferenca midis kthimit faktik mbi aktivet e skemës dhe kthimit të pritur mbi aktivet e skemës është një fitim ose humbje aktuariale neto; kjo përfshihet në fitimet dhe humbjet neto aktuariale mbi detyrimin për përfitime të përcaktuara gjatë përcaktimit të vlerës neto, e cila krahasohet me kufijtë e “korridorit” 10% të specifikuar në paragrafin 92.
- 106 Kthimi i pritur mbi aktivet e skemës mbështetet në pritjet e tregut në fillim të periudhës, në lidhje me kthimet gjatë gjithë jetës së detyrimit përkatës. Kthimi i pritur mbi aktivet e skemës pasqyron ndryshimet e vlerës së drejtë të aktiveve të skemës të mbajtura gjatë periudhës si rezultat i kontributeve faktike që i paguhen fondit dhe i përfitimeve që paguan fondi.

<b>Shembull që ilustron paragrafin 106</b>	
Më 1 janar 20X1, vlera e drejtë e aktiveve të skemës ishte 10000, ndërsa fitimet neto aktuariale progresive të panjohura ishin 760. Më 30 qershor 20X1, skema pagoi përfitime prej 1900 dhe arkëtoi kontribute prej 4900. Më 31 dhjetor 20X1, vlera e drejtë e aktiveve të skemës ishte 15000, ndërsa vlera aktuale e detyrimit për përfitime të përcaktuara ishte 14792. Humbjet neto aktuariale mbi detyrimin për vitin 20X1 ishin 60.	
Më 1 janar 20X1, njësia raportuese ka bërë këto çmuarje, në bazë të çmimeve të tregut më atë datë:	
	%
Të ardhura nga interesat dhe dividendët pas tatimit, të pagueshme nga fondi	9.25
Fitime neto të realizuara dhe të porealizuara mbi aktivet e skemës (pas tatimit)	2.00
Kostot e administrimit	(1.00)
Norma e pritur e kthimit	10.25



<b>Shembull që ilustron paragrafin 106</b>	
<i>Për vitin 20X1, kthimi i pritur dhe ai faktik mbi aktivet e skemës janë si më poshtë:</i>	
<i>Kthimi mbi 10000 të mbajtura për 12 muaj me 10.25%</i>	1,025
<i>Kthimi mbi 3000 të mbajtura për gjashtë muaj me 5% (e barasvlershme me 10.25% në vit, e përbërë, çdo gjashtë muaj)</i>	150
<i>Kthimi i pritur mbi aktivet e skemës për vitin 20X1</i>	1,175
<i>Vlera e drejtë e aktiveve të skemës më 31 dhjetor 20X1</i>	15,000
<i>Minus vlera e drejtë e aktiveve të skemës më 1 janar 20X1</i>	(10,000)
<i>Minus kontributet e arkëtuara</i>	(4,900)
<i>Plus përfitimet e paguara</i>	1,900
<i>Kthimi i pritur mbi aktivet e skemës</i>	2,000
<i>Diferenca midis kthimit të pritur mbi aktivet e skemës (1175) dhe kthimit faktik mbi aktivet e skemës (2000) është fitim neto aktuarial prej 825. Për rrjedhojë, fitimet neto aktuariale të panjohura progresive janë 1525 (760 plus 825 minus 60). Në bazë të paragrafit 92, kufijtë e korridorit vendosen në 1500 (që është vlera më e madhe midis: (i) 10% të 15,000 dhe (ii) 10% të 14,792). Në vitin tjetër (20X2), njësia ekonomike njeh në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve një fitim neto aktuarial prej 25 (1525 minus 1500) të pjesëtuar me jetën e pritur mesatare të mbetur të punës të punonjësve në fjalë.</i>	
<i>Kthimi i pritur mbi aktivet e skemës për vitin 20X2 mbështetet në pritjet e tregut më 1/1/X2 në lidhje me kthimet gjatë gjithë jetës së detyrimit.</i>	

- 107 Gjatë përcaktimit të kthimit të pritur dhe atij faktik mbi aktivet e skemës, njësia ekonomike i zbritet kostot e pritura administrative, me përjashtim të atyre të përfshira në hipotezat aktuariale, të përdorura për të matur detyrimin.

### **Kombinimet e biznesit**

- 108 Në një kombinim biznesi, njësia ekonomike njeh aktivet dhe pasivet që lindin nga përfitimet e pas-punësimit me vlerën aktuale të detyrimit minus vlerën e drejtë të aktive të skemës (shih SNRF 3 *Kombinimet e bizneseve*). Vlera aktuale e detyrimit përfshin të gjithë përbërësit e mëposhtëm, edhe nëse subjekti i blerë nuk i ka njohur ende në datën e blerjes:
- (a) fitimet dhe humbjet neto aktuariale të cilat kanë lindur përpara datës së blerjes (pavarësisht nëse bien apo jo brenda “korridorit” prej 10%);
  - (b) koston e shërbimit të shkuar, e cila ka lindur nga ndryshimet e përfitimeve, ose nga futja e një skeme, përpara datës së blerjes; dhe
  - (c) shumat të cilat, në bazë të dispozitave kalimtare të paragrafit 155(b), njësia ekonomike e blerë nuk i ka njohur,

## Reduktimet dhe shlyerjet

- 109 Njësia ekonomike i njeh fitimet ose humbjet nga reduktimet ose shlyerjet e një skeme me përfitime të përcaktuara, në kohën kur ndodh reduktimi ose shlyerja. Fitimi ose humbja neto nga një reduktim ose shlyerje përbëhet nga:
- (a) ndryshimi i vlerës aktuale të detyrimit për përfitime të përcaktuara;
  - (b) ndryshimi i vlerës së drejtë të aktiveve të skemës;
  - (c) fitimet dhe humbjet neto aktuariale të lidhura dhe kostoja e shërbimit të shkuar, të cilat në bazë të paragrafëve 92 dhe 96, nuk kanë qënë njohur.
- 110 Përpara përcaktimit të efektit të reduktimit ose shlyerjes, njësia ekonomike duhet të rimatë detyrimin (dhe aktivet e lidhura të skemës, nëse ka) duke përdorur hipotezat aktuariale (përfshirë normat aktuale të interesit të tregut dhe çmimet të tjera aktuale të tregut).
- 111 Reduktimi ndodh kur një njësi ekonomike:
- (a) demonstroi se është e angazhuar për të bërë një reduktim të konsiderueshëm të numrit të punonjësve të mbuluar nga skema; ose
  - (b) amendon kushtet e një skeme përfitimesh të përcaktuara në mënyrë të atillë, që një element material i shërbimit të ardhshëm të punonjësve ekzistues nuk kualifikohet më për përfitime, ose do të kualifikohet vetëm për përfitime të reduktuara.
- Reduktimi mund të lindë nga një ngjarje e izoluar, siç është mbyllja e një linje prodhimi, ndërprerja e një operacioni ose pushimi apo pezullimi i një skeme. Një ngjarje është mjaftueshmërisht materiale për të plotësuar kushtet si një reduktim nëse njohja e një fitimi apo humbje neto nga reduktimi do të kishte një efekt material mbi pasqyrat financiare. Reduktimet lidhen shpesh me një ristrukturim. Për rrjedhojë, njësia ekonomike e kontabilizon reduktimin në të njëjtën kohë me ristrukturimin e lidhur me të.
- 112 Shlyerja ndodh kur njësia ekonomike bëhet palë në një transaksion i cili eliminon të gjitha detyrimet e mëtejshme ligjore ose konstruktive për një pjesë ose për të gjitha përfitimet e ofruara në bazë të një skeme përfitimesh të përcaktuara për shembull, kur bëhet një pagesë me një shumë të njëhershme në mjete monetare për ose në emër të pjesëmarrësve të skemës në këmbim të të drejtave të tyre për të marrë përfitimet e përcaktuara të pas-punësimit.
- 113 Në disa raste, njësia ekonomike blen një policë sigurimi për të financuar një pjesë ose të gjitha përfitimet e punonjësve që lidhen me shërbimin e punonjësve në periudhën aktuale dhe ato të mëparshme. Blerja e një police të tillë nuk është shlyerje nëse njësia ekonomike vazhdon ta mbajë detyrimin ligjor ose konstruktiv (shih paragrafin 39) për të paguar shumën të tjerë nëse siguroesi nuk i paguan përfitimet e punonjësve të specifikuar në policën e sigurimit. Paragrafët 104A–104D trajtojnë njohjen dhe matjen e të drejtave të rimbursimit në kuadër të policave të sigurimit që nuk janë aktive të skemës.
- 114 Shlyerja ndodh së bashku me reduktimin nëse një skemë mbyllet në mënyrë të tillë që detyrimi shlyhet dhe skema pushon së ekzistuari. Megjithatë, mbyllja e një skeme nuk është reduktim apo shlyerje, nëse skema zëvendësohet me një skemë të re, e cila ofron përfitime të cilat në thelb janë identike.
- 115 Kur një reduktim lidhet vetëm me disa prej punonjësve të mbuluar nga skema, ose kur shlyhet vetëm një pjesë e detyrimit, fitimi ose humbja neto përfshin një përqindje përpjesëtimore të kostos së mëparshme të shërbimit të shkuar të panjohur dhe të fitimeve e humbjeve neto aktuariale të mëparshme (dhe të vlerave kalimtare të mbetura të panjohura në bazë të paragrafit 155(b)). Përqindja përpjesëtimore gjendet në bazë të vlerës aktuale të detyrimeve përpara dhe pas reduktimit ose shlyerjes, nëse nuk ka ndonjë bazë më racionale për rethanat. Për shembull, mund të jetë e përshtatshme të aplikohet fitimi neto që lind nga reduktimi ose shlyerja e të njëjtës skemë për të eliminuar në fillim koston e panjohur të shërbimit të shkuar që lidhet me të njëjtën skemë.

### Shembull që ilustron paragrafin 115

Një njësi ekonomike ndërpret një segment shfrytëzimi dhe punonjësit e segmentit që nuk vijon nuk do të fitojnë përfitime të mëtejshme. Ky është një reduktim pa një shlyerje. Duke përdorur hipotezat aktuariale (përfshirë normat e interesit aktuale të tregut dhe çmimet e tjera aktuale të tregut) menjëherë përpara reduktimit, njësi ekonomike ka një detyrim për përfitime të përcaktuara me vlerë aktuale neto prej 1,000, aktive të skemës me vlerë të drejtë prej 820 dhe fitime neto aktuariale progresive të panjohura prej 50. Njësia ekonomike ka filluar ta përdorë për herë të parë Standardin një vit më parë. Kjo e ka rritur pasivin neto me 100, gjë të cilën njësia ekonomike ka vendosur ta njohë gjatë pesë vjetëve (shih paragrafin 155(b)). Reduktimi e ul vlerën aktuale neto të detyrimit me 100 deri në 900.

*Nga fitimet neto aktuariale të panjohura më parë dhe vlerat kalimtare, 10% (100/1,000) lidhet me atë pjesë të detyrimit e cila është eliminuar përmes reduktimit. Për rrjedhojë, efekti i reduktimit është si më poshtë:*

	<i>Përpara reduktimit</i>	<i>Fitimi nga reduktimi</i>	<i>Pas reduktimit</i>
<i>Vlera aktuale neto e detyrimit</i>	1,000	(100)	900
<i>Vlera e drejtë e aktiveve të skemës</i>	(820)	–	(820)
	<hr/>	<hr/>	<hr/>
	180	(100)	80
<i>Fitimet aktuariale të panjohura</i>	50	(5)	45
<i>Vlera kalimtare e panjohur (100 x 4/5)</i>	(80)	8	(72)
	<hr/>	<hr/>	<hr/>
<i>Pasivi neto i njohur në bilanc</i>	150	(97)	53

## Paraqitja

### Kompensimi

- 116 Njësia ekonomike e kompenson një aktiv që lidhet me një skemë kundrejt një pasivi që lidhet me një skemë tjetër, atëherë dhe vetëm atëherë, kur njësia ekonomike:
- (a) ka të drejtën e zbatueshme me ligj për ta përdorur suficitin e një skeme për të shlyer detyrimet që ka në kuadër të një skeme tjetër; dhe
  - (b) ka në mend ose ta shlyejë detyrimin mbi një bazë neto ose të realizojë suficitin në një skemë dhe ta shlyejë në të njëjtën kohë detyrimin që ka në kuadër të skemës tjetër.
- 117 Kriteret e kompensimit janë të ngjashme me ato të vendosura për instrumentet financiare në SNK 32 *Instrumentet financiare. paraqitja.*

### Dallimi afatshkurtër /afatgjatë

- 118 Disa njësi ekonomike bëjnë dallimin e aktiveve dhe pasiveve afatshkurtra nga aktivet dhe pasivet afatgjata. Ky Standard nuk specifikon nëse një njësi ekonomike duhet apo jo të bëjë dallimin midis pjesëve afatshkurtra dhe afatgjata të aktiveve dhe pasiveve që lindin nga përfitimet e pas-punësimit.

## **Përbërësit financiarë të kostove të përfitimeve të pas-punësimit**

- 119 Ky Standard nuk specifikon nëse një njësi ekonomike duhet apo jo të paraqesë koston e shërbimit aktual, koston e interesave dhe kthimin e pritur mbi aktivet e skemës, përbërës të një zëri të vetëm të të ardhurave ose shpenzimeve në brendësi të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

## **Dhënia e informacioneve shpjeguese**

- 120 Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues i mundëson përdoruesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë natyrën e skemave me përfitime të përcaktuara dhe efektet financiare të ndryshimeve në këto skema gjatë periudhës.
- 120A Njësia ekonomike jep këto informacione shpjeguese për skemat me përfitime të përcaktuara:
- (a) politikën kontabël të njësisë ekonomike për fitimet dhe humbjet neto aktuariale.
  - (b) një përshkrim të përgjithshëm të llojit të skemës.
  - (c) një rakordim të tepricës në çelje dhe në mbyllje të vlerës aktuale të detyrimit për përfitime të përcaktuara duke treguar veças, nëse duhet, efektet e periudhës që i ngarkohet secilit prej elementeve të mëposhtme:
    - (i) kostos aktuale e shërbimit,
    - (ii) kostos së interesave,
    - (iii) kontributeve të pjesëmarrësve të skemës,
    - (iv) fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale,
    - (v) ndryshimeve të kursit të këmbimit valutor mbi skemat të matura në një monedhë të ndryshme nga monedha e paraqitjes e njësisë ekonomike,
    - (vi) përfitimeve të paguara,
    - (vii) kostos së shërbimit të kaluar,
    - (viii) kombinimeve të biznesit,
    - (ix) reduktimeve dhe
    - (x) shlyerjeve.
  - (d) një analizë të detyrimit për përfitime të përcaktuara në lidhje me shumat që lindin nga skemat, të cilat janë tërësisht të pafinancuara dhe shumat që lindin nga skemat, të cilat janë tërësisht ose pjesërisht të financuara.
  - (e) një rakordim të tepricave në çelje dhe në mbyllje të vlerës së drejtë të aktiveve të skemës dhe të tepricave në çelje dhe mbyllje të të drejtës për rimbursim, të njohur si aktiv në përputhje me paragrafin 104A, duke treguar veças, nëse duhet, efektet e periudhës që i ngarkohet secilit prej elementeve të mëposhtme:
    - (i) kthimit të pritur mbi aktivet e skemës,
    - (ii) fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale,
    - (iii) ndryshimeve të kursit të këmbimit valutor mbi skemat të matura në një monedhë të ndryshme nga monedha e paraqitjes e njësisë ekonomike,
    - (iv) kontributeve të punëdhënësve,
    - (v) kontributeve të pjesëmarrësve të skemës,
    - (vi) përfitimeve të paguara,
    - (vii) kombinimeve të biznesit dhe
    - (viii) shlyerjeve.
  - (f) një rakordim të vlerës aktuale të detyrimit për përfitime të përcaktuara në (c) dhe vlerës së drejtë të aktiveve të skemës në (e) me aktivet dhe pasivet e njohura në bilanc, duke treguar, si minimum:
    - (i) fitimet ose humbjet aktuariale neto që nuk janë njohur në bilanc (shih paragrafin 92);
    - (ii) kostot e shërbimeve të shkuara që nuk janë njohur në bilanc (shih paragrafin 96);

- (iii) çdo shumë që nuk është njohur si aktiv, për shkak të kufirit të vendosur në paragrafin 58(b);
  - (iv) vlerën e drejtë në datën e bilancit të së drejtës për rimbursim, të njohur si aktiv në përputhje me paragrafin 104A (me një përshkrim të shkurtër të lidhjes midis të drejtës së rimbursimit dhe detyrimit të lidhur me të); dhe
  - (v) shumat e tjera të njohura në bilanc.
- (g) shpenzimin gjithsej të njohur në fitim ose humbje për secilin prej elementeve të mëposhtme dhe zërat në të cilat janë përfshirë:
- (i) kostoja e shërbimit aktual;
  - (ii) kostoja e interesave;
  - (iii) kthimi i pritur mbi aktivet e skemës,
  - (iv) kthimi i pritur mbi të drejtën për rimbursim, të njohur si aktiv në përputhje me paragrafin 104A;
  - (v) fitimet dhe humbjet neto aktuariale;
  - (vi) kostoja e shërbimit të shkuar;
  - (vii) efekti i reduktimit ose shlyerjes; dhe
  - (viii) efekti i kufirit të paragrafit 58(b).
- (h) shumën gjithsej të njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura për secilin prej elementeve të mëposhtme:
- (i) fitimet dhe humbjet neto aktuariale; dhe
  - (iii) efekti i kufirit të paragrafit 58(b).
- (i) për njësitë ekonomike të cilat i njohin fitimet dhe humbjet neto aktuariale në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në përputhje me paragrafin 93A, shumën progresive të fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura.
- (j) për secilën kategori kryesore të aktiveve të skemës, që duhet të përfshijë, pa u kufizuar në to, instrumentet e kapitalit neto, instrumentet e borxhit, aktivet afatgjata të investuara dhe të gjitha aktivet e tjera, përqindjen ose vlerën me të cilën merr pjesë secila kategori në vlerën e drejtë të aktiveve gjithsej të skemës.
- (k) vlerat e përfshira në vlerën e drejtë të aktiveve të skemës për:
- (i) secilën kategori të instrumenteve të veta financiare të njësisë ekonomike; dhe
  - (ii) ndonjë pasuri të zotëruar, ose aktivet në përdorim të njësisë ekonomike.
- (l) një përshkrim të bazës së përdorur për të përcaktuar normën e përgjithshme të pritur të kthimit mbi aktivet, përfshirë efektin e kategorive kryesore të aktiveve të skemës.
- (m) kthimin faktik mbi aktivet e skemës, si edhe kthimin faktik mbi të drejtën për rimbursim të njohur si aktiv në përputhje me paragrafin 104A.
- (n) hipotezat aktuariale kryesore të përdorura në datën e bilancin, përfshirë, kur duhet:
- (i) normat e skontimit;
  - (ii) normat e pritura të kthimit mbi aktivet e skemës për periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare;
  - (iii) normat e pritura të kthimit për periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare mbi të drejtën për rimbursim të njohur si aktiv në përputhje me paragrafin 104A.
  - (iv) normat e pritura të rritjeve të pagave (dhe të ndryshimeve të një indeksi ose variabli të përcaktuar në kushtet formale ose konstruktive të një skeme si bazë për rritjet e ardhshme të përfitimeve);
  - (v) normat e prirjeve të kostove mjekësore; dhe
  - (vi) çdo hipotezë aktuariale tjetër materiale të përdorur.
  - (vii) njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për çdo hipotezë aktuariale në terma absolutë (për shembull, si përqindje absolute) dhe jo thjesht si një marzh midis përqindjeve të ndryshme ose variablave të tjera.

(o) **efektin e një rritjeje me një pikë përqindjeje dhe efektin e një rënieje me një pikë përqindjeje në normat e prirjeve të kostove mjekësore të supozuara mbi:**

(i) **shumën e bashkuar të komponentëve të kostos së shërbimit aktual dhe përbërësve të kostos së interesit në kostot mjekësore neto periodike të pas-punësimit; dhe**

(ii) **detyrimin e akumuluar për përfitime të pas-punësimit për kostot mjekësore.**

**Për qëllimet e dhënies së këtij informacioni, të gjitha supozimet e tjera mbahen konstante. Për skemat që ushtrojnë aktivitet në kushtet e inflacionit të lartë, informacioni duhet të jetë efekt i një rritjeje ose zvogëlimi me përqindje i normës së prirjes të kostove mjekësore të supozuara me një rëndësi të ngjashme me një pikë përqindjeje në një mjedis me inflacion të ulët.**

(p) **shumat për periudhën vjetore aktuale dhe katër periudhat e mëparshme të:**

(i) **vlerës aktuale të detyrimit për përfitime të përcaktuara, vlerës së drejtë të aktiveve të skemës dhe suficitit ose deficitit të skemës; dhe**

(ii) **rregullimeve të llogarisë së eksperiencës që lindin nga:**

(A) **pasivet e skemës të shprehura ose si (1) vlerë ose (2) përqindje të pasiveve të skemës në datën e bilancit dhe**

(B) **aktivet e skemës të shprehura ose si (1) vlerë ose (2) përqindje të aktiveve të skemës në datën e bilancit.**

(q) **vlerësimi më i mirë i punëdhënësit me t'u përcaktuar në mënyrë të arsyeshme në lidhje me kontributet e pritura për tu paguar skemës gjatë periudhës vjetore që fillon pas datës së bilancit.**

121 Paragrafi 120A(b) kërkon një përshkrim të përgjithshëm të llojit të skemës. Një përshkrim i tillë, për shembull, bën dallimin midis skemave të pensioneve të bazuar në pagën e shesht, nga skemat e pensioneve të bazuara në pagën përmbyllëse dhe nga skemat mjekësore të pas-punësimit. Përshkrimi i skemës duhet të përfshijë praktikatat joformale të cilat çojnë në detyrime konstruktive të përfshira në matjen e detyrimit për përfitime të përcaktuara në përputhje me paragrafin 52. Nuk kërkohen hollësi të mëtejshme.

122 Kur një njësi ekonomike ka më shumë se një skemë me përfitime të përcaktuara, dhënia e informacioneve shpjeguese mund të bëhet në formën e shumës gjithsej, veças për çdo skemë ose në grupime të tilla që konsiderohen si më të vlefshme. Mund të jetë e dobishme të dallohen grupimet përmes kriterëve të tilla si më poshtë:

(a) vendndodhja gjeografike e skemës, për shembull, duke bërë dallimin midis skemave vendase dhe skemave të huaja; ose

(b) nëse skemat u nënshtrohen apo jo rreziqeve të ndryshme materiale, duke bërë dallimin midis skemave të pensioneve të bazuara në pagën e sheshtit nga skemat e pensioneve të bazuara në pagën përmbyllëse dhe nga skemat mjekësore të pas-punësimit.

Kur një njësi ekonomike jep informacione shpjeguese në formën e shumës gjithsej për një grupim të skemave, këto informacione jepen në formën e mesatareve të ponderuara ose si diapazone relativisht të ngushta.

123 Paragrafi 30 kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese shtesë për skemat me përfitime të përcaktuara me disa punëdhënës të cilat trajtohen, sikur të ishin skema me kontribute të përcaktuara.

124 Kur e kërkon SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura*, njësi ekonomike jep informacion për:

(a) transaksionet me palët e lidhura me skemat e përfitimeve të pas-punësimit; dhe

(b) përfitimet e pas-punësimit për punonjësit drejtues kryesorë.

125 Kur e kërkon SNK 37 *Provizionet, pasivet e kushtëzuara dhe aktivet e kushtëzuara*, njësi ekonomike jep informacion për pasivet e kushtëzuara që lindin nga detyrimet për përfitime të pas-punësimit.

## **Përfitime të tjera afatgjata të punonjësve**

---

126 Përfitimet e tjera afatgjata të punonjësve përfshijnë, për shembull:

(a) mungesa të kompensuara afatgjata të tilla si leje pas një vjetërsie të gjatë në punë ose leje studimore;

(b) përfitime të tjera pas një vjetërsie të gjatë në punë;

(c) përfitime të paafëtisë afatgjatë në punë;

(d) pjesëmarrja në fitim dhe shpërblime pune të pagueshme brenda dymbëdhjetë muajsh pas mbylljes së periudhës në të cilën i kryejnë shërbimet përkatëse punonjësit; dhe

- (e) kompensim që paguhet dymbëdhjetë muaj ose më shumë pas fundit të periudhës në të cilën është fituar.
- 127 Matja e përfitimeve të tjera të punonjësve, zakonisht, nuk i nënshtrohet të njëjtës shkallë pasigurie me matjen e përfitimeve të pas-punësimit. Për më tepër, futja apo ndryshimi i përfitimeve të tjera afatgjata të punonjësve shumë rrallë shkakton një kosto materiale të shërbimit të shkuar. Për këto arsye, ky Standard kërkon një metodë më të thjeshtë kontabilizimi për përfitimet e tjera afatgjata të punonjësve: Kjo metodë ndryshon nga kontabiliteti i kërkuar për përfitimet e pas-punësimit, si më poshtë:
- (a) fitimet dhe humbjet neto aktuariale njihen menjëherë dhe nuk aplikohet asnjë “korridor”; dhe
- (b) e gjithë kostoja e shërbimit të shkuar njihet menjëherë.

## Njohja dhe matja

- 128 Shuma e njohur si pasiv për përfitimet e tjera afatgjata të punonjësve është shuma gjithsej neto e këtyre vlerave:
- (a) vlera aktuale e detyrimit për përfitime të përcaktuara në datën e bilancit (shih paragrafin 64);
- (b) minus vlerën e drejtë në datën e bilancit të aktiveve të skemës (nëse ka) nga të cilat do të shlyhen drejtpërdrejt detyrimet (shih paragrafët 102-104).

Gjatë matjes së pasivit, njësia ekonomike aplikon paragrafët 49-91, duke përjashtuar paragrafët 54 dhe 61. Njësia ekonomike zbaton paragrafin 104A për njohjen dhe matjen e të drejtës për rimbursim.

- 129 Për përfitimet e tjera afatgjata, njësia ekonomike njeh shumën gjithsej neto të vlerave të mëposhtme si shpenzim ose (në varësi të paragrafit 58) si të ardhur, me përjashtim të rasteve kur ndonjë Standard tjetër kërkon ose lejon përfshirjen e tyre në koston e një aktivi:
- (a) kostoja e shërbimit aktual (shih paragrafët 63-91);
- (b) kostoja e interesave (shih paragrafin 82);
- (c) kthimi i pritur mbi aktivet e skemës (shih paragrafët 105-107) dhe mbi të drejtën për rimbursim të njohur si aktiv (shih paragrafin 104A);
- (d) fitimet dhe humbjet neto aktuariale, që njihen të gjitha menjëherë;
- (e) kostoja e shërbimi të shkuar, që njihet e gjitha menjëherë; dhe
- (f) efekti i reduktimeve ose shlyerjeve (shih paragrafët 109 dhe 110).

- 130 Një formë e përfitimeve të tjera afatgjata të punonjësve është pagesa për paaftësinë afatgjatë për punë. Nëse niveli i përfitimit bazohet në gjatësinë e periudhës së shërbimit, detyrimi lind kur kryhet shërbimi. Matja e këtij detyrimi pasqyron probabilitetin se do të lindë nevoja të bëhet pagesa dhe gjatësinë e kohës për të cilën pritet të bëhet kjo pagesë. Nëse niveli i përfitimit është i njëjtë për çdo punonjës të paaftë për punë pavarësisht numrit të viteve të shërbimit, kostoja e pritur e këtyre përfitimeve njihet kur ndodh ngjarja e cila shkakton paaftësinë afatgjatë për punë.

## Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 131 Edhe pse ky Standard nuk kërkon dhënie informacionesh shpjeguese specifike për përfitimet e tjera afatgjata të punonjësve, dhënia e informacioneve shpjeguese mund të kërkohej nga Standarde të tjera për shembull, kur shpenzimi që lind nga këto përfitime është materiale dhe për rrjedhojë, do të kërkonte dhënien e informacioneve shpjeguese në përputhje me SNK 1 *Paraqitja e pasqyrave financiare*. Kur e kërkon SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura*, njësia ekonomike jep informacion për përfitimet e tjera afatgjata të punonjësve për personelin drejtues kryesor.

## Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës.

- 132 Ky Standard i trajton veças përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës sepse ngjarja e cila bën të lindë një detyrim është ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe jo shërbimi që kryen punonjësi.

## Njohja

- 133 Njësia ekonomike i njeh përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës si pasiv atëherë dhe vetëm atëherë, kur njësia ekonomike demonstroi se është e angazhuar ose:

- (a) për të ndërprerë marrëdhëniet e punës të një punonjësi ose një grupi punonjësish përpara datës normale të daljes në pension; ose
  - (b) për të dhënë përfitime nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës si rezultat i një oferte të bërë për të nxitur largimin vullnetar nga puna.
- 134 Një njësi ekonomike demonstroi se është e angazhuar për një ndërprerje të marrëdhënieve të punës atëherë dhe vetëm atëherë, kur ajo ka një plan zyrtar të hollësishëm për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe nuk ka mundësi realiste tërheqjeje. Skema e hollësishme përfshin, minimalisht:
- (a) vendin, funksionin dhe numrin e përafërt të punonjësve, shërbimi i të cilëve do të ndërpritet;
  - (b) përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës për secilën kategori pune ose funksion; dhe
  - (c) kohën kur do të vihet në zbatim plani. Zbatimi fillon sa më shpejt dhe periudha kohore për përfundimin e zbatimit është e tillë që të mos ketë gjasa për ndryshime të konsiderueshme të planit.
- 135 Një njësi ekonomike mund të jetë e angazhuar, përmes legjislacionit, kontratave apo ndonjë marrëveshjeje tjetër me punonjësit apo përfaqësuesit e tyre ose përmes një detyrimi konstruktiv të bazuar në praktikën e veprimtarisë, në rutinën apo dëshirën për të vepruar me barazi, për t'u dhënë para (ose përfitime të tjera) punonjësve kur ajo ndërpret marrëdhëniet e punës me ta. Pagesa të tilla janë përfitime nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, zakonisht janë pagesa me një shumë të vetme, por ndonjëherë përfshijnë edhe:
- (a) rritjen e përfitimeve të pensionit ose të përfitimeve të tjera të pas-punësimit, ose indirekt përmes një skeme të përfitimeve të punonjësve ose drejtpërdrejt; dhe
  - (b) pagën deri në fund të një periudhe të njoftuar nëse punonjësi nuk kryen asnjë shërbim, që i jep përfitime ekonomike njësisë ekonomike.
- 136 Disa përfitime të punonjësve janë të pagueshme pavarësisht arsyes së largimit të tyre. Pagesa e këtyre përfitimeve është e sigurt (në varësi të fitimit të së drejtës për t'i marrë apo të kërkesave për periudhën minimale të shërbimit) por koha e bërjes së pagesave është e pasigurt. Edhe pse përfitime të tilla në disa vende përshkruhen si dëmshpërblim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës apo pagesa gratis për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe një njësi ekonomike i kontabilizon si përfitime të pas-punësimit. Disa njësi ekonomike japin një nivel më të ulët përfitimi për ndërprerjen vullnetare të marrëdhënieve të punës me kërkesë të punonjësit (në thelb, përfitim pas-punësimi) se sa për ndërprerjen e pavullnetshme të marrëdhënieve të punës me kërkesë të njësisë ekonomike. Përfitimi shtesë i pagueshëm në rastin e ndërprerjes së pavullnetshme të marrëdhënieve të punës është një përfitim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.
- 137 Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës nuk i japin një njësi ekonomike përfitime ekonomike të ardhshme dhe njihen menjëherë si shpenzim.
- 138 Kur njësi ekonomike njeh përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, ajo mund t'i kontabilizojë ato edhe si një reduktim të përfitimeve për pensione apo të përfitimeve të tjera të punonjësve (shih paragrafin 109).

## Matja

- 139 Kur përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës janë të pagueshme pas më shumë se 12 muajve pas datës së bilancit, ato skontohe duke përdorur normën e skontimit të specifikuar në paragrafin 78.
- 140 Nëse bëhet një ofertë për të nxitur largimin vullnetar nga puna, matja e përfitimeve nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës bazohet në numrin e punonjësve që priten ta pranojnë ofertën.

## Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 141 Kur ka pasiguri për numrin e punonjësve të cilët do ta pranojnë ofertën për përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, ekziston një pasiv i kushtëzuar. Sikurse e kërkon edhe SNK 37, njësi ekonomike jep informacion për pasivin e kushtëzuar nëse mundësia e flukseve monetare dalëse për shlyerjen, nuk është shumë e vogël.
- 142 Sikurse e kërkon SNK 1, njësi ekonomike jep informacion për natyrën dhe vlerën e shpenzimit, nëse ai është material. Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës mund të çojnë në një shpenzim që ka nevojë për dhënie të informacioneve shpjeguese për të përmbushur këtë kërkesë.
- 143 Kur e kërkon SNK 24, njësi ekonomike jep informacion për përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës për personelin drejtues kryesor.



## Dispozita kalimtare

- 153 Në këtë pjesë përcaktohet trajtimi për periudhën kalimtare për skemat me përfitime të përcaktuara. Kur një njësi ekonomike e përdor për herë të parë këtë Standard për përfitimet e tjera të punonjësve, ajo aplikon SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*.
- 154 Në momentin e përdorimit për herë të parë të këtij Standardi, njësia ekonomike përcakton pasivin e vet kalimtar për skemat me përfitime të përcaktuara në atë datë si:
- vlerën aktuale e detyrimit (shih paragrafin 64) në datën e adoptimit;
  - minus vlerën e drejtë, në datën e adoptimit, ë aktiveve të skemës (nëse ka) nga të cilat do të shlyhen drejtpërdrejt detyrimet (shih paragrafët 102-104);
  - minus koston e shërbimit të së kaluarës që do të njihet, në bazë të paragrafit 96, në periudhat e mëvonshme.
- 155 Nëse pasivi kalimtar është më i madh se pasivi që do të ishte njohur në të njëjtën datë në bazë të politikës së mëparshme kontabël të njësisë ekonomike, njësia ekonomike merr një vendim të pakthyeshem për ta njohur këtë rritje si pjesë të pasivit të vet për përfitime të përcaktuara në bazë të paragrafit 54:
- menjëherë, në bazë të SNK 8; ose
  - si shpenzim linear deri në pesë vjet pas datës së adoptimit të Standardit. Nëse njësia ekonomike zgjedh pikën (b), atëherë ajo:
    - aplikon limitin e përshkruar në paragrafin 58(b) për matjen e çdo aktivi të njohur në bilanc;
    - në çdo datë të bilancit bën të ditur: (1) vlerën e rritjes që mbetet e panjohur; dhe (2) vlerën e njohur në periudhën aktuale;
    - e kufizon njohjen e fitimeve neto aktuariale të mëpasshme (por jo njohjen e kostos negative të shërbimit të shkuar) si më poshtë. Nëse duhet njohur një fitim aktuarial në bazë të paragrafëve 92 dhe 93, njësia ekonomike e njuh këtë fitim aktuarial vetëm për atë sa fitimet neto aktuariale të panjohura progresive (përpara njohjes së këtij fitimi aktuarial) janë më të mëdha se pjesa e panjohur e pasivit kalimtar; dhe
    - përfshin pjesën e lidhur të pasivit kalimtar të panjohur gjatë përcaktimit të fitimit ose humbjes së mëpasshme nga shlyerja apo reduktimi.
- Nëse pasivi kalimtar është më i vogël se pasivi që do të ishte njohur në të njëjtën datë në bazë të politikës së mëparshme kontabël të njësisë ekonomike, njësia ekonomike e njuh menjëherë këtë rënie në bazë të SNK 8.
- 156 Në momentin e përdorimit për herë të parë të këtij Standardi, efekti i ndryshimit të politikës kontabël i përfshin të gjitha fitimet dhe humbjet neto aktuariale, të cilat kishin lindur në periudhat e mëparshme edhe sikur ato të bien brenda “korridorit” 10% të specifikuar në paragrafin 92.

### Shembull që ilustron paragrafët 154 deri 156

Më 31 dhjetor 1998, bilanci i një njësie ekonomike përfshin një pasiv për pensione prej 100. Njësia ekonomike adopton këtë Standard duke filluar nga data 1 janar 1999, kur vlera aktuale e detyrimit në bazë të Standardit është 1300, ndërsa vlera e drejtë e aktiveve të skemës është 1000. Më 1 janar 1993 njësia ekonomike i pati përmirësuar pensionet (kostoja për përfitimet e pakushtëzuara: 160; ndërsa periudha mesatare e mbetur në këtë datë deri në datën e kushtëzimit: 10 vjet).

*Efekti kalimtar është si vijon:*

Vlera aktuale e detyrimit	1,300
Vlera e drejtë e aktiveve të skemës	(1,000)
Minus: koston e shërbimit të shkuar që do të njihet në periudhat e mëvonshme (160 × 4/10)	(64)

<b>Shembull që ilustron paragrafët 154 deri 156</b>	
<i>Pasivi kalimtar</i>	236
<i>Pasivi i njohur më parë</i>	100
<i>Rritja e pasivit</i>	136
<i>Njësia ekonomike mund të vendosë ta njohë rritjen prej 136 ose menjëherë ose gjatë një periudhe deri në 5 vjet. Ky vendim është i pakthyeshëm.</i>	
<p>Më datë 31 dhjetor 1999, vlera aktuale e detyrimit në bazë të këtij Standardi është 1400, ndërsa vlera e drejtë e aktiveve të skemës është 1050. Fitimet neto aktuariale të panjohura progresive qysh prej datës së fillimit të aplikimit të Standardit janë 120. Jeta e pritur mesatare e mbetur e punës e punonjësve që marrin pjesë në skemë ishte tetë vjet. Njësia ekonomike ka filluar të ndjekë një politikë për njohjen e të gjitha fitimeve dhe humbjeve neto aktuariale, sikurse lejohet në paragrafin 93.</p>	
<i>Efekti i kufirit të paragrafit 58(b)(iii) është si vijon.</i>	
<i>Fitimet aktuariale të panjohura progresive neto</i>	120
<i>Pjesa e panjohur e pasivit kalimtar (136 × 4/5)</i>	(109)
<i>Fitimi maksimal që do të njihet (paragrafi 155(b)(iii))</i>	11

## **Data e hyrjes në fuqi**

- 157 Ky Standard hyn në fuqi për pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat vjetore që fillojnë më datë 1 janar 1999 ose pas kësaj date, me përjashtim të rasteve të specifikuara në paragrafët 159 dhe 159A. Inkurajohet zbatimi i më hershëm. Nëse një njësi ekonomike e aplikon këtë Standard për kostot e përfitimeve të pensioneve për pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat të cilat fillojnë përpara datës 1 janar 1999, ajo bën të ditur faktin që ka aplikuar këtë Standard dhe jo SNK 19 *Kostot e përfitimeve të pensioneve të aprovuar në 1993*.
- 158 Ky Standard zëvendëson SNK 19 *Kostot e përfitimeve të pensioneve të aprovuar në 1993*.
- 159 Paragrafët e mëposhtme bëhen të zbatueshme për pasqyrat financiare vjetore\* që mbulojnë periudhat që fillojnë më 1 janar 2001 ose pas kësaj date:
- (a) përkufizimi i ndryshuar i aktiveve të skemës në paragrafin 7 dhe përkufizimet përkatëse të aktiveve të mbajtura nga një fond përfitimesh afatgjata të punonjësve dhe të policës kualifikuese të sigurimeve; dhe
  - (b) kërkesat për njohjen dhe matjen për rimbursimet në paragrafët 104A, 128 dhe 129 dhe dhënia e informacioneve përkatëse të kërkuara nga paragrafët 120A(iv), 120A(g)(iv), 120A(m) dhe 120A(n)(iii).

\* Paragrafët 159 dhe 159A bazohen në termin “pasqyrat financiare vjetore” në përputhje me mënyrën më të qartë të të shprehurit për të shkruar datat e hyrjes në fuqi të pranuar në 1998. Paragrafi 157 bazohet në termin “pasqyrat financiare”.

**Inkurajohet zbatimi i më hershëm. Nëqoftëse zbatimi i mëhershëm ndikon në pasqyrat financiare, njësi ekonomike jep informacione shpjeguese për këtë fakt.**

**159A** Amendamenti në paragrafin 58A bëhet i zbatueshëm për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që mbyllen më datë 31 maj 2002 ose pas kësaj date.

**Inkurajohet zbatimi i më hershëm. [Në qoftë adoptimi i më hershëm ka ndikim në pasqyrat financiare, një njësi ekonomike duhet të japë informacion për këtë fakt.**

**159B** Njësia ekonomike zbaton kërkesat e paragrafëve 32A, 34–34B, 61 dhe 120–121 për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2006. Inkurajohet zbatimi i më hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto amendamente për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2006, ajo duhet ta bëjë me dije këtë fakt.

**159C** Mundësia e dhënë në paragrafët 93A–93D mund të përdoret për periudhat vjetore të cilat mbyllen më datë 16 dhjetor 2004 ose pas kësaj date. Një njësi ekonomike e cila e përdor këtë mundësi për periudhat vjetore që fillojnë përpara datës 1 janar 2006 aplikon amendamentet e paragrafëve 32A, 34–34B, 61 dhe 120–121.

160 Kur njësi ekonomike i ndryshon politikat e veta kontabël për të pasqyruar ndryshimet e specifikuar në paragrafët 159–159C, zbatohet SNK 8. Kur këto ndryshime zbatohen në mënyrë retrospektive, sikurse e kërkon SNK 8, njësi ekonomike i trajton këto ndryshime sikur të ishin aplikuar në të njëjtën kohë me pjesën tjetër të këtij Standardi, vetëm se njësi ekonomike mund t'i bëjë me dije shumat e kërkuara nga paragrafi 120A(p) në momentin e përcaktimit të këtyre shumave për secilën periudhë vjetore në mënyrë prospektive, që nga periudha e parë vjetore e paraqitur në pasqyrat financiare në të cilat njësi ekonomike ka zbatuar për herë të parë amendamentet e paragrafit 120A.